




RAPORT

MBI

VEPRIMTARINË MËSIMORE, AKADEMIKE E SHKENCORE SI DHE VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN 2013



Tiranë, Janar 2014



Studi di progetto del palazzo dell'Opera Dopolavoro Albanese.
Palazzo dell'Opera Dopolavoro Albanese (in collaborazione).

PASQYRA E LËNDËS

Të përgjithshme

- A. Misioni i Universitetit të Arteve
- B. Objektivat e Universitetit të Arteve
- C. Autoritetet dhe Organet Drejtuese

Pjesa e parë: VEPRIMTARIA MËSIMORE, AKADEMIKE E SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

- Kreu i parë: Veprimtaria Mësimore
- Kreu i dytë: Veprimtaria Kërkimore, Shkencore e Artistike
- Kreu i tretë: Biblioteka Shkencore
- Kreu i katërt: Galeria FAP
- Kreu i pestë: Dega Mësimore dhe e Zhvillimit të Kurrikulave

Pjesa e dytë: VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

- Kreu i parë: Projekte dhe Investime
- Kreu i dytë: Burimet Njerëzore
- Kreu i tretë: Marrëdhëniet me Jashtë
- Kreu i katërt: Çështje juridike
- Kreu i pestë: Administrimi financiar
- Kreu i gjashtë: Auditi i brendshëm

TË PËRGJITHSHME

A. MISIONI I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Universiteti i Arteve është një institucion publik i arsimit të lartë, i cili e zhvillon veprimtarinë e vet mësimore, kërkimore, artistike e administrative duke u bazuar kryesisht në legjislacionin për arsimin e lartë, e më specifiku në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe kuadrin nënligjor në zbatim të këtij ligji. Gjithashtu në sferën e veprimtarisë së Universitetit të Arteve gjejnë zbatim edhe ligje të tjera specifike për fusha të veçanta.

Universiteti i Arteve gjithashtu mbështet veprimtarinë në Statutin e vet, i cili përbën dokumentin themelor të miratuar nga Senati Akademik. Në këtë dokument, në nenin 3 është i përcaktuar edhe misioni i Universitetit të Arteve, i cili përmbledhet në pikat e mëposhtme:

- a. *Ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës;*
- b. *Zhvillimin e mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;*
- c. *Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës;*
- ç. *Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës.*
- d. *Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;*
- dh. *Ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.*

B. AUTONOMIA E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Autonomia e Universitetit të Arteve shprehet në: vetëqeverisjen e saj, për të organizuar strukturat e saj të brendshme dhe veprimtaritë e saj, nëpërmjet këtij statuti dhe rregulloreve, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi; të drejtën për hartimin dhe zhvillimin e pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit; të drejtën për të caktuar kritere të pranimit të studentëve në programet e studimeve; të drejtën për të mbledhur fonde dhe për të përfituar mjete materiale, sipas rregullave në fuqi, si dhe të drejtën për të realizuar marrëveshje të pavarura me Qeverinë ose organizma të tjerë për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore; të drejtën për të realizuar marrëveshje me institucione, shoqëri biznesi ose organizata të tjera, vendase ose të huaja, publike ose private; të drejtën për të administruar fondet publike e të ardhura të tjera, që disponon sipas mënyrës së përshkruar në ligj.

Liria akademike e Universitetit të Arteve shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë e kërkimit shkencor e lirinë e krijimit. Veprimtaria e Universitetit të Arteve zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

C. AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për arsimin e lartë si dhe me dispozitat e Statutit të Universitetit të Arteve, autoritetet drejtuese dhe organet drejtuese të Universitetit të Arteve janë si më poshtë:

1. Autoritetet Drejtuese:

- Rektori;
- Dekani;
- Përgjegjësi i departamentit.

2. Organet administruese

- senati akademik,
- rektorati,
- këshilli i administrimit,
- këshilli i etikës,
- këshilli i fakultetit.

PJESA E PARË
VEPRIMTARIA MËSIMORE, AKADEMIKE E SHKENCORE
NË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



KREU I PARË

VEPRIMTARIA MËSIMORE

- I. **Sigurimi i planeve dhe programeve mësimore në përputhje me rregulloren dhe statutin e UART**
 1. **Hartimi dhe përditësimi i planeve mësimore ekzistuese dhe të reja sipas rregullores dhe statutit të UART, dhe paraqitja e tyre Rektorit dhe Senatit Akademik për miratim.**

Për realizimin e këtij objekti dhe duke u bazuar në nenin 7, pika 2 të rregullores së ciklit të parë, janë ndjekur këto procedura në bashkëpunim me fakultetet e UART:

- a) Zhvillimi i një procesi në formë sa më të gjerë diskutimi për riorganizimin e programeve mësimore ku të përfshihej i gjithë stafi akademik me kohë të plotë.
- b) Ndjekja e procedurave për realizimin e këtij objekti është bërë në mënyrë permanente, deri në përcjelljen e tyre në Këshillat e Fakulteteve përkatëse.
- c) Me Vendim të Këshillit të Fakultetit të Arteve të Bukura Nr. 116 prot. datë 30. 05. 2013, është dërguar për t'u miratuar projekt struktura e planeve mësimore për programet e studimit Bachelor dhe Master, për vitin akademik 2013-2104.
- d) Me Vendim të Këshillit të Fakultetit të Artit Skenik Nr. 354 datë 19. 06. 2013, është dërguar për t'u miratuar projekt struktura e planeve mësimore për programet e studimit Bachelor dhe Master, për vitin akademik 2013-2104.
- e) Me Vendim të Këshillit të Fakultetit të Muzikës Nr. 212 datë 03. 06. 2013, është dërguar për t'u miratuar projekt struktura e planeve mësimore për programet e studimit Bachelor dhe Master, për vitin akademik 2013 e në vazhdim.
- f) Zhvillimi i procesit jo normal mbi miratimin e planeve mësimore nga këshilli i Fakultetit të Muzikës, ishte një pengesë në ecurinë e këtij procesi. Për këtë arsye u pa me vend ndërhyrja e Rektorit dhe ZV- Rektorit të UART të cilët morën pjesë në mbledhjet e KFM, ku më pas u realizua miratimi i programeve mësimore me tekst të përcaktuar si më poshtë:
 - i. *Të miratojë Planet Mësimore të FM 2013 e në vazhdim me ndryshimet e mëposhtëme:*
 - Në Ciklin II të studimeve të hiqet lënda Antropologji Kulturore;
 - Në Ciklin II të studimeve të rivendoset lënda Histori e Estetikës Muzikore;
 - Në Ciklin II të studimeve lënda Semantikë Muzikore të përfshihet në lëndën Semiotikë Muzikore”;
- g) Janë bërë verifikimet përkatëse mbi ndryshimet e shprehura nga këto këshilla dhe është përgatitur materiali për t'u miratuar në Senatin Akademik. FM kishte pasqyruar ndryshime, ndërsa dy Fakultet e tjera nuk kishin asnjë ndryshim konkret të shprehur.

Konstatimet pas verifikimit janë si më poshtë:

 - i. Fakulteti i Arteve të Bukura nuk shprehej për ndonjë ndryshim të planeve mësimore nga viti i kaluar akademik
 - ii. Fakulteti i Artit Skenik shpreheshin; Departamenti Aktrim dhe Regji Filmi-TV për rishikim të planeve mësimore duhet të jenë koherent zhvillimeve bashkohore ndërsa Departamenti i Regji –Skenografi-Koreografi-Teori Arti, harmonizimin e tyre në bazë të programeve të veprimtarive formuese duke qënë më afër këtyre kërkesave.
 - iii. Fakulteti i Muzikës shprehej vetëm për tre ndryshimet e sipërcituara në pikën f.1.
Senati Akademik i UART, me Vendimin Nr. 8, Datë 20.06.2013, miratoi Strukturën Mësimore të Fakultetit të Muzikës (lidhja 1), të Fakultetit të Artit Skenik (lidhja 2), të

Fakultetit të Arteve të Bukura (lidhja 3) në Universitetin e Arteve për vitin Akademik 2013 – 2014 sipas lidhjeve përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.

- h) Rektori i UART me anë të Urdhrit Nr 96, datë 27.11.2013, ka ngritur një grup kontrolli "Për ushtrimin e Kontrollit të Brendshëm të Ligjshmërisë në Fakultetet e Universitetit të Arteve". (në proces)

Problematika te shfaqura:

- a) Mos zbatueshmëria e strukturave të fakulteteve për respektimin e afateve kohore të përcaktuar në Rregulloret e Ciklit të parë dhe Ciklit të dytë të studimeve të UART.
- b) Dekanët duhet të zbatojnë me korrektësi të gjithë etapat për këtë proces, i cili është parësor në mbarëvajtjen e të gjithë procesit akademik.
- c) Duke qenë se të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë do të kalojnë në akreditim duhet një rikompozim të gjithë planeve mësimore, sipas Nenit 5, të Rregulloreve të Ciklit të parë dhe Ciklit të dytë të miratuara nga Senati Akademik.
- d) Ky format i përshtatur, është dërguar në të tre Fakultetet e UART por nuk ka gjetur akoma zbatim. Meqenëse është momenti i rishikimit të programeve mësimore duhet reflektuar menjëherë përshtatja e tyre.

2. Zbatimin në praktikë e të gjithë planeve mësimore të miratuara për çdo program studimi duke e finalizuar me realizimin e ngarkesës mësimore nga ana e personelit akademik.

Realizimi i këtij objektivi bëhet në zbatueshmëri të udhëzimit 20, 40, 25.

- a) Shpërndarja e ngarkesës në të tre fakultetet e UART, është bërë duke ndjekur procedurat e Udhëzimit 20, përfshi këtu edhe mbinormën 30%.
- b) Marrëveshja Paraprake që duhet lidhur nga Përgjegjësit e Njësive Bazë me secilin prej anëtarëve të personelit akademik të brendshëm për organizimin e kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtari të ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik, sipas Udhëzimit Nr. 20, datë 09.05.2008, pika 14, 18, nuk është kryer në fillimin të vitit akademik dhe aktualisht është në perfundim.
- c) Anëtarët e personelit akademik të brendshëm nuk e plotësojnë të gjithë ngarkesën 30% mbi normë.
- d) Duke pasur në vëmendje specifikat e veçanta për programe të ndryshme studimi, personeli akademik i ftuar, zhvillon lëndë të një kategorie më të lartë se kualifikimi i tyre, por nën drejtimin e një titullari.

3. Ndjekja dhe kontrolli mbi ecurinë e proceseve mësimore në përputhje me plan-programet, zbatimin e tyre, rregullin dhe korrektesën e zhvillimit të procesit mësimor, praktikave, provimeve, si dhe vijueshmërinë e saktë të dokumentacioneve përkatëse në lidhje me sekretaritë mësimore për çdo fakultet.

- a) Rektorati në mënyrë periodike ka ushtruar kontrole verifikimi të dokumentacioneve mbi grafikun vjetor të:

- zbatimit të programeve mësimore,
 - orareve mësimore dhe shpërndarjes së tyre,
 - plotësimin e regjistrave,
 - pjesëmarrjen e stafit akademik në mësimdhënie,
 - ndjekjen e problematikave mbi cilësinë e procesit.
- b) Procesi i ndjekjes së dokumentacioneve në lidhje me sekretaritë mësimore, plotësimi dhe hedhja e tyre, është një moment që monitorohet. Kujdesi nga ana e sekretarive mësimore mbi përpikërinë e administrimit të këtij procesi është për t'u vlerësuar, pasi në këtë proces nuk ka pasur asnjë problem.
- c) Në të gjitha rastet kur konstatohet ndonjë problem në proceset mësimore, zv.rektori për anën mësimore ka ndërhyrë dhe ndihmuar në zgjidhjen dhe vazhdimësinë normale të procesit mësimor.

4. Procedurat e hartimit dhe miratimit të rregulloreve të konkursit për ciklin e parë dhe ciklin e dytë si dhe zbatimi i tyre.

Një ndër momentet më të rëndësishme në Universitetin e Arteve, është ndërtimi dhe menaxhimi i etapave procedurale mbi zhvillimin e konkurseve të pranimit. Ky moment fillon me hartimin e Rregulloreve të konkursit të pranimit për të dy Ciklet e studimit. Në ecurinë e kësaj procedure janë ndjekur këto etapa:

- a) Kërkesa drejtuar Dekanëve të Fakulteteve për riorganizimin e Rregulloreve të konkurseve të pranimit e mbështetur në pikën 5 të nenit 33, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të gjitha programet e studimit në fakultetet e UART.
- b) Në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve u krye rishikimi i Rregulloreve të konkurseve të pranimit, mbështetur në ato ekzistuese por duke reflektuar në to për çdo program studimi problemet e konstatuara të një viti më parë.
- c) Planifikimi i kuotave për konkurrentët duke parë mundësitë tona për një shfrytëzim maksimal të kapaciteteve mbartëse.
- d) Politika dhe strategjitë që duhet të ndjekin fakultet për përthithjen e konkurrentëve sipas programeve të studimit.
- e) Ndërtimi i kriterëve të konkurseve të detajuara për çdo program studimi në UART për të dy Ciklet e Studimit.
- f) Miratimi i tyre në Senatën Akademik me Vendim Nr. 05, datë 23.04.2013.
- g) Dërgimi i tyre në MAS.
- a) Pasqyrimi në faqen e Zyrtare të UART, i Rregulloreve për secilin Fakultet si dhe të kriterëve të konkurseve për çdo program studimi.

5. Organizimi dhe ndjekja e provimeve për të tre fakultetet në programet e studimit Bachelor dhe Master.

Për organizimin e kontrollit mbi ndjekjen e provimeve në të tre fakultetet, Me Urdhër të Rektorit Nr. 12, datë 07.06.2013 "Për Ushtrimin e Kontrollit në Fakultete Për Mbarëvajtjen e Procesit të Provimeve", u zhvillua kontrolli në periudhën 15 qershor – 15 korrik 2013.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se:

- a) procesi i provimeve për vitin akademik 2012-2013, në të tre fakultetet e UART, në tërësinë e tij, u zhvillua sipas kalendarit të përcaktuar dhe sipas Rregullores së Ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe Rregullores së ciklit të dytë të studimeve Master gjitha rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Statutin e UART mbi modalitetet e provimeve.
- b) Në të tre Fakultetet e Universitetit të Arteve, Kalendarit i Provimeve dhe Diplomave për programet e studimeve Bachelor dhe Master ishte i depozituar në Rektorat dhe i vendosur në vende të dukshme të fakultetit, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara në rregullore.
- c) Në të tre Fakultetet e Universitetit të Arteve, më datë 14.06.2013, ishte gati e gjithë infrastruktura, punonjësit mësimorë, punonjësit e administratës, mjediset ku do të zhvilloheshin provimet si edhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për provime.
- d) Në të tre Fakultetet e Universitetit të Arteve, është respektuar me korrektesë procedura e zhvillimit të provimit, që nga marrja e Fletës së Provimit në prani të gjithë anëtarëve të komisionit, zhvillimi i provimit, firmosja e Fletëve të provimit nga të tre (apo më shumë, sipas rastit) anëtarët e komisionit dhe deri në dorëzimin në Sekretariatë Mësimore të Fletëve të Provimit dhe dokumentacionit përkatës.
- e) Në të tre Fakultetet, ka pasur një angazhim maksimal të sekretarive mësimore si dhe laborantëve në ndihmë të zhvillimit të procesit të provimeve.
- f) Në Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Muzikës ka pasur spostime të datave dhe orareve të provimeve, apo ndryshime të anëtarëve të komisionit; nga Kalendarit i datave të provimeve të miratuara, dhe të dërguara në Rektorat.
- g) Ndryshimet e datave të provimi janë shoqëruar me shkresa të miratuara nga Përgjegjësit e Njesisë Bazë dhe Dekanët e Fakulteteve, respektive
- h) Shkak kryesor për këto ndryshime, në më të shumtën e rasteve, siç edhe është përligjur në shkresat zyrtare, ka qenë mungesa e hapësirave për zhvillimin e procesit të provimeve e cila krijon vështirësi në plotësimin me salla, si dhe zënia e ambienteve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kjo ishte një nga arsyet që detyruan ndryshimin e datave të provimeve.
- i) Në Fakultetin e Arteve të Bukura, procesi i zhvillimit të provimeve është zhvilluar pa problematika për t'u veçuar.

Problematika të shfaqura:

- a) Nga verifikimi i bërë, konstatohet se është i domosdoshëm një koordinim më i saktë ndërmjet njësive bazë, për të menaxhuar ambientet e përbashkëta, studiot, Salla Black Box, Black Box i vogël, Salla e Shfaqjeve.
- b) Verifikimi dhe përcaktimi i mjediseve ku do të zhvillohen provimet duhet të fillojë menjëherë pas përfundimit të sezonit të provimeve të semestrit II, duke u kërkuar të gjithë pedagogëve kalendarin e provimeve, sipas llojit të performancës të përcaktuar në programin mësimor të lëndëve që drejtojnë të miratuar në Njësitë Bazë.
- c) Në disa raste, është konstatuar mos prezenca e pedagogëve në komisionet e provimeve.
- d) Mos koordinimin në përpilimin e komisionit prej tre anëtarësh, sidomos kur në to janë parashikuar si komision pedagogë të ftuar.

- e) Për komisionet e lëndëve të formimit teorik, nuk është bërë asnjë koordinim paraprak me njësinë e Lëndëve Teorike, e atashuar pranë Departamentit të Regji, Skenografi, Koreografi, Teori Arti në Fakultetin e Artit Skenik, ose, në raste të tjera, ishin caktuar në komisione pedagogë të ftuar, pa verifikuar paraprakisht me to kalendarin e provimeve.
- f) Në të gjitha provimet e Zhvilluara në Fakultetin e Muzikës dhe në Fakultetin e Artit Skenik në të shumtën e tyre Stafi akademik me kohë të plotë nuk ishte prezent si pjesëmarrës si dëgjues apo si shikues të provimeve të Njësive Bazë respektive. Bëhet fjalë për ato lloj provimesh të zhvilluara në sallën Çesk Zadeja, sallën e pedagogëve, në sallën e madhe të UART ose në Sallën Black Box.

II. Përditësimi i rregulloreve të UART dhe monitorimi i ndjekjes së rregulloreve nga Fakultetet

1. Në mënyrë të vazhdueshme dhe me kërkesë nga Dekanët përshtat rregulloret e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve bazuar mbi problemet e ngritura dhe ndryshimeve në legjislacion.

- a) Duke marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Dekanët e Fakulteteve si dhe nga konstatimet gjatë procesit mësimor, të ciklit të parë Bachelor i janë propozuar Senatit Akademik ndryshimet e konstatuara.
- b) Senati Akademik me Vendim Nr. 11, datë 19.11.2013, miratoi tekstin integral të Rregullores së ciklit të parë Bachelor.
- c) Me përfundimin e ciklit të plotë të studimeve Master, u pa e nevojshme ndërhyrja dhe riorganizimi i kësaj Rregulloreje, në përshtatshmëri me procesin mësimor të zhvilluar.
- d) Draft rregullorja u ri-konceptua dhe u përshtat sipas të gjitha standardeve të nevojshme që kërkon ky cikël studimi.
- e) Drafti i Rregullores së Ciklit të dytë të studimeve Master, ju propozua i plotë dhe Senati Akademik e miratoi me Vendimin Nr. 12 datë 19.11.2013.

III. Sigurimi i një stafi akademik të kualifikuar (me kohë të plotë dhe të ftuar) dhe ndjekja e mësimdhënies sipas planit dhe programit mësimor nga stafi akademik

1. Në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik, ushtrohet kontroll në të tre fakultet lidhur me çështjet e mëposhtme :

- i. Realizimi i orëve të mësimit nga pedagogët
- ii. Prania me plotësimi e regjistrave
- iii. Mbajtja e evidencave në Sekretari me procesin mësimor
- iv. Përputhshmëria e orareve në procesin mësimor

2. Hartimi dhe vlerësimi i kriterëve për kandidatët e ftuar si pedagog në Universitetin e Arteve duke zbatuar të V.K.M. nr. 331, datë 25.03.2009 "Për ndarjen në nivele brenda kategorive të personelit akademik, në institucionet e arsimit të lartë, emërtimin dhe renditjen e tyre, si dhe kriteret dhe kualifikimet për çdo vend pune"

- a) Në formë shkresore ju është kërkuar Dekanëve të Fakulteteve të UART, depozitimi në Rektorat i projekt propozimeve për personelin akademik të ftuar sipas programeve të studimit dhe numrin e tyre për çdo program për vitin akademik 2013-2014 për ciklin e parë të studimit Bachelor dhe ciklin e dytë të studimit Master për të tre Fakultet e UART.
- b) Në bashkëpunim me Degën e Burimeve Njerëzore dhe Degën Juridike, është krijuar një draft propozim drejtuar Rektorit mbi modalitete e rekrutimeve të reja për personel të ftuar mësimdhënës. Hartimi i draftit është bërë në zbatim të Ligjit 7941, datë 21.05.2007, si dhe VKM 331, dhe Udhëzimeve në fuqi.
- c) Me Urdhrin nr. 48, datë 18.07.2013, të Rektorit të UART, janë miratuar modalitet e pranimit për pedagogë të ftuar për vitin akademik 2013-2014, si dhe kriteret për vlerësimin e kandidatëve të ftuar. Shpallja e tyre në faqen zyrtare të UART u bë me datë 18.07.2013, duke i dhënë një muaj kohë për përgatitjen e dokumentacionit për secilin kandidat.
- d) Pasqyra informative mbi Personelin Akademik të ftuar:

Fakulteti	Kërkesat nga Fakultetet	Konkurrent të regjistruar	Fitues
Muzika	184	235	165
Arti Skenik	34	49	41
Artet e Bukura	30	36	31
Total	248	320	237

Bazuar në aktet ligjore, Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe Statutin e UART Rektori është shprehur me urdher të veçantë për gjithë pedagogët e ftuar të cilët plotësojnë kriteret e vendosura. Por me duhet të nënvizoj me keqardhje faktin se në Fakultetin e Muzikës e konkretisht në Departamentin e Interpretimit janë angazhuar punonjës mesimor të ftuar pa kaluar në procedurat e mesiperme. E kjo kuptohet që krijon situata aspak të dobishme për këtë proces, pasi Rektori i UART bazuar gjithmone në aktet ligjore lidh kontrate dhe mund të pranojë si bashkëpunetore në UART vetëm ata të cilët janë aprovuar nga Komisionet përkatëse të Fakulteteve, komisione këto që drejtohen nga Dekanet dhe me asnjë tjetër. Këto ngarkojnë me përgjegjësi drejtuesit e strukturave përkatëse. Me duhet po ashtu të bëj me dije se Fakulteti i Muzikës në UART angazhon personelin akademik të ftuar në numër më të madh në UART, rreth 65%.

3. Riorganizimi i organikës dhe ndarja në nivele e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Arteve sipas moduleve përkatëse.

Përgjatë vitit 2013, në Universitetin e Arteve, personeli akademik me kohë të plotë në vazhdimësi ka pasur ngritje kualifikimi në Grada dhe Tituj akademik. Kjo ka krijuar një mundësi më të mirë për vetë stafin por edhe për përfituesit direkt, studentët. Plotësimi pothuajse në të gjithë programet me titullarë lënde me grada apo Tituj akademik, i krijon mundësinë Universitetit të Arteve të renditet ndër Institucionet e Arsimit të Lartë Publik me personel akademik me kohë të plotë ndër më të kualifikuarit përsa i përket niveleve dhe kategorive. Në Fakultetin e Muzikës duke pasur gjithsej 40 programe studimi, në të dyja ciklet, është e pamundur plotësimi i këtij stafi me titullarë lënde. Në mbështetje të VKM 331, personeli akademik është mbështetur nën drejtimin e tyre, me titullarë lënde të një programi të përafërt me to.

Personeli akademik në Fakultetin e Muzikës, në Fakultetin e Artit Skenik dhe në Fakultetin e Arteve të Bukura është në përgjithësi në përshtatshmëri me pozicionin e punës të marrë nga punëdhënësi;

IV. Regjistrimi i studentëve

Cikli i I-rë (Bachelor) 2013-2014

Nr	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Nr studentëve të pritshëm	Nr studentëve aktivë	Nr studentëve aktivë troje	Nr studentëve TOTALI
I FAKULTETI I MUZIKËS					
1	MUZIKOLOGJI	6	6	0	12
2	KOMPOZICION	8	10	3	21
3	DIRIGJIM	4	5	0	9
4	PIANO	9	18	0	27
5	VIOLINË	13	24	0	37
6	VIOLONÇEL	3	3	0	6
7	VIOLË	3	8	0	11
8	KITARË	7	14	0	21
9	KONTRABAS	1	3	0	4
10	FLAUT	5	9	0	14
11	OBOE	3	5	0	8
12	KLARINETË	6	16	1	23
13	FAGOT	1	2	0	3
14	KORNO	2	5	0	7
15	TROMBË	1	4	0	5
16	TROMBON	1	6	0	7
17	BASTUB	1	1	0	2
18	KANTO	13	18	4	35
19	PEDAGOGJI MUZIKORE	10	27	0	37
20	FIZARMONIKË KLASIKE	5	12	0	17
	TOTAL FM	102	196	8	306
II FAKULTETI I ARTIT SKENIK					
1	AKTRIM	12	22	3	37
2	REGJI	10	18	0	28
3	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI	9	16	0	25
4	KOREOGRAFI	10	27	3	40

5	REGJI FILMI DHE TV	12	24	4	40
	TOTAL FAS	53	107	10	170
III FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA					
1	PIKTURË	60	118	7	185
2	SKULPTURË	15	19	0	34
	TOTAL FAB	75	137	7	219
	TOTALI UART	385	743	43	695

Cikli i II-të (Master) 2013-2014

Nr	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Nr studentëve të pritshëm	Nr studentëve aktivë	Nr studentëve aktivë troje	Nr studentëve TOTALI
I FAKULTETI I MUZIKËS					
1	MUZIKOLOGJI (Master Shkencor)	1	2	0	3
2	KOMPOZICION (Master i Arteve të Bukura)	3	1	2	6
3	DIRIGJIM (Master i Arteve të Bukura)	2	3	0	5
4	PIANO (Master i Arteve të Bukura)	5	5	1	11
5	VIOLINË (Master i Arteve të Bukura)	6	4	0	10
6	VIOLONÇEL (Master i Arteve të Bukura)	2	3	0	5
7	VIOLË (Master i Arteve të Bukura)	3	3	0	6
8	KONTRABAS (Master i Arteve të Bukura)	3	1	0	4
9	FLAUT (Master i Arteve të Bukura)	4	2	0	6
10	OBOE (Master i Arteve të Bukura)	1	1	0	2
11	KLARINETË (Master i Arteve të Bukura)	4	5	0	9

Nr	EMËRTIMI I PROGRAMIT	Nr studentëve të pritshëm	Nr studentëve aktivë	Nr studentëve aktivë troje	Nr studentëve TOTALI
I FAKULTETI I MUZIKËS					
12	FAGOT (Master i Arteve të Bukura)	2	0	0	2
13	KORNO (Master i Arteve të Bukura)	0	1	0	1
14	TROMBË (Master i Arteve të Bukura)	3	6	0	9
15	TROMBON (Master i Arteve të Bukura)	1	1	0	2
16	KANTO (Master i Arteve të Bukura)	14	11	2	27
17	PEDAGOGJI MUZIKORE (Master Profesional)	10	0	0	10
18	FIZARMONIKË KLASIKE (Master Profesional)	3	0	0	3
19	KITARË (Master Profesional)	5	0	0	5
20	BASTUB (Master Profesional)	2	0	0	2
	TOTAL FM	74	49	5	128

II FAKULTETI I ARTIT SKENIK					
21	AKTRIM (Master i Arteve të Bukura)	10	8	1	19
22	REGJI TEATRI & SPEKTAKLI (Master i Arteve të Bukura)	9	10	1	20
23	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI (Master i Arteve të Bukura)	7	9	0	16
24	KOREOGRAFI (Master i Arteve të Bukura)	9	8	3	20
25	REGJI FILMI DHE TV (Master i Arteve të Bukura)	10	14	0	24
	TOTAL FAS	45	49	5	99
III FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA					
26	PIKTURË MONUMENTALE (Master i Arteve të Bukura)	7	7	0	14
27	PIKTURË TEKSTIL & MODE (Master i Arteve të Bukura)	10	7	1	18
28	PIKTURË GRAFIK (Master i Arteve të Bukura)	14	17	0	31
29	PIKTURË KAVALET (Master i Arteve të Bukura)	9	11	0	20
30	PIKTURË MULTIMEDIA (Master i Arteve të Bukura)	9	8	1	18
31	SKULPTURË (Master i Arteve të Bukura)	7	4	0	11
32	SKULPTURË QERAMIKË (Master i Arteve të Bukura)	3	6	0	9
	TOTAL FAB	59	60	2	121
TOTALI UART		297	256	22	575

Diplomimet për vitin akademik 2012-2013 sipas programeve të studit për të tre Fakultet e UART.

DIPLOMIME NË CIKLIN E PARË TË STUDIMIT (Bachelor)

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	
I FAKULTETI MUZIKË		
1	KOMPOZICION	3
2	DIRIGJIM	2
3	MUZIKOLOGJI	4
4	PIANO	4
5	VIOLINË	11
6	VIOLË	2
7	VIOLONÇEL	3
8	KONTRABAS	3
9	KITARË	7
10	FLAUT	6
11	OBOE	1
12	KLARINETË	5
13	FAGOT	1

DIPLOMIME NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMIT (Master)

14	TROMBË	4
15	TROMBON	2
16	BASTUB	1
17	KORNO	0
18	KANTO	18
19	PEDAGOGJI MUZIKORE	11
20	FIZARMONIKË KLASIKE	2
	TOTAL FM	90
II FAKULTETI I ARTIT SKENIK		
1	AKTRIM	13
2	REGJI	7
3	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI	13
4	KOREOGRAFI	19
5	REGJI FILMI DHE TV	5
	TOTAL FAS	57
III FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA		



1	PIKTURË MONUMENTALE	8
2	PIKTURË TEKSTIL & MODE	16
3	PIKTURË GRAFIK	17
4	PIKTURË KAVALET	11
5	PIKTURË MULTIMEDIA	22
6	SKULPTURË	11
7	SKULPTURË QERAMIKË	3
	TOTAL FAB	88
	TOTALI (Diploma BSC) UART	235

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	
I FAKULTETI MUZIKË		
1	PEDAGOGJI MUZIKORE (Master	4
2	FIZARMONIKË KLASIKE (Master Profesional)	1
3	KITARË (Master Profesional)	1
4	BASTUB (Master Profesional)	0
5	MUZIKOLOGJI (Master Shkencor)	2
6	KOMPOZICION (MAB)	3
7	DIRIGJIM (MAB)	0
8	PIANO (MAB)	2
9	VIOLINË (MAB)	0
10	VIOLË (MAB)	0
11	VIOLONÇEL (MAB)	0
12	KONTRABAS (MAB)	1
13	FLAUT (MAB)	4

14	OBOE (MAB)	0
15	KLARINETË (MAB)	2
16	FAGOT (MAB)	1
17	TROMBË (MAB)	1
18	TROMBON (MAB)	0
19	KORNO (MAB)	0
20	KANTO (MAB)	8
	TOTAL FM	30
II FAKULTETI I ARTIT SKENIK		
1	AKTRIM (MAB)	8
2	REGJI TEATRI & SPEKTAKLI(MAB)	4
3	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI(MAB)	8
4	KOREOGRAFI (MAB)	1
5	REGJI FILMI DHE TV (MAB)	2
	TOTAL FAS	23
III FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA		
1	PIKTURË MONUMENTALE (MAB)	7
2	PIKTURË TEKSTIL & MODE (MAB)	5
3	PIKTURË GRAFIK (MAB)	11
4	PIKTURË KAVALET (MAB)	6
5	PIKTURË MULTIMEDIA (MAB)	4
6	SKULPTURË (MAB)	3
7	SKULPTURË QERAMIKË (MAB)	4
	TOTAL FAB	40
	TOTALI (Diploma MSC) UART	93

Diplomimet për vitin akademik 2012-2013 sipas programeve të studimit.

FAKULTETI I MUZIKES				
Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	%	PROGRAMI I STUDIMIT	%
CIKLI I STUDIMEVE BACHELOR			CIKLI I STUDIMEVE "MASTER"	
1	MUZIKOLOGJI	89	MUZIKOLOGJI (Master Shkencor)	100
2	KOMPOZICION	71	KOMPOZICION (MAB)	100
3	DIRIGJIM	83	DIRIGJIM (MAB)	100
4	PIANO	70	PIANO (MAB)	88
5	VIOLINË	79	VIOLINË (MAB)	75
6	VIOLONÇEL	100	VIOLONÇEL (MAB)	66
7	VIOLË	50	VIOLË (MAB)	100
8	KITARË	72	KONTRABAS (MAB)	100
9	KONTRABAS	100	FLAUT (MAB)	100
10	FLAUT	100	OBOE (MAB)	100



11	OBOE	83	KLARINETË (MAB)	100
12	KLARINETË	100	FAGOT (MAB)	100
13	FAGOT	100	KORNO (MAB)	100
14	KORNO	100	TROMBË (MAB)	100
15	TROMBË	100	TROMBON (MAB)	100
16	TROMBON	89	KANTO (MAB)	90
17	BASTUB	100	BASTUB (Master Profesional)	0
18	KANTO	86	PEDAGOGJI MUZIKORE (Master Profesional)	100
19	PEDAGOGJI MUZIKORE	92	FIZARMONIKË KLASIKE (Master Profesional)	100
20	FIZARMONIKË KLASIKE	100	KITARË (Master Profesional)	100
TOTALI BACHELOR		85%	TOTALI MAB dhe MASTER SHKENCOR	92%
			TOTALI MASTER PROFESIONAL"	100%

FAKULTETI I ARTIT SKENIK		
Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	%
CIKLI I STUDIMEVE BACHELOR		
1	AKTRIM	74
2	REGJI	84
3	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI	86
4	KOREOGRAFI	57
5	REGJI FILMI & TV	52
TOTALI BACHELOR		70%
CIKLI I STUDIMEVE "MASTER "		
1	AKTRIM (MAB)	45
2	REGJI TEATRI & SPEKTAKLI(MAB)	81
3	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI(MAB)	100
4	KOREOGRAFI (MAB)	100
5	REGJI FILMI & TV (MAB)	100
TOTALI MASTER		85%



FAKULTETI I ARTEVE TE BUKURA		
Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	%
CIKLI I STUDIMEVE BACHELOR		
1	Viti I - PIKTURË	93
2	Viti I - SKULPTURË	75
	Viti II - III	
1	PIKTURË MONUMENTALE	90
2	PIKTURË TEKSTIL & MODE	100
3	PIKTURË GRAFIKË	93
4	PIKTURË KAVALET	100
5	PIKTURË MULTIMEDIA	97
6	SKULPTURË	95
7	SKULPTURË QERAMIKË	100
TOTALI BACHELOR		95%
CIKLI I STUDIMEVE "MASTER I ARTEVE TE BUKURA"		
1	PIKTURË MONUMENTALE (MAB)	100
2	PIKTURË TEKSTIL & MODE (MAB)	100
3	PIKTURË GRAFIK (MAB)	92
4	PIKTURË KAVALET (MAB)	94
5	PIKTURË MULTIMEDIA (MAB)	100
6	SKULPTURË (MAB)	87
7	SKULPTURË QERAMIKË (MAB)	100
TOTALI "MASTER I ARTEVE TE BUKURA"		96%

KREU I DYTË

VEPRIMTARIA KËRKIMORE, SHKENCORE E ARTISTIKE

Nje nga problemet që përbën shqetësim, është pjesëmarrja e paket e pedagogeve të shkolles sone në debate që kanë të bëjnë me artin e kulturën. Mungojnë inisjativat konkrete në fakultete për të mbajtur konferenca shkencore mbi tema të ndryshme të artit e kulturës. Disa herë ka ndodhur që fakultetet të djegin fondet financiare të vena në dispozicion për aktivitetin shkencor e është për të ardhur vertet keq! Është një numër i vogël kolegësh që shprehen në shyp apo forma të tjera e një pjesë tjetër e madhe prej vitësh nuk shkruajnë një shkrim, nuk marrin pjesë në një konferencë shkencore me një kumtesë. Ky është një problem i madh për të gjithë ata të cilët gëzojnë titull shkencor por edhe më i madh për të gjithë ata që aspirojnë të marrin një titull shkencor. Ka ndodhur që është marrë titulli e me pas shterim i energjive të cilat do të përbenin dobi jo vetëm për individin por sidomos për komunitetin dhe studentet. E në këto kuader vazhdon të ngelet e përealizuar një nga detyrat themelore që na ngarkon Ligji i Arsimit të Lartë. Hapja e shkolles së Doktoratës. Në Fakultetet e UART janë ngritur prej kohësh Këshillat e Profesoreve me detyrë kryesore organizimin dhe drejtimin e studimeve të doktoratës dhe të kualifikimit shkencor e pedagogjik pas doktoratës. Ky detyrim është jetik për rritjen e cilësive të studimeve dhe ofertës akademike të UART. Këshillat e Profesoreve duhet domosdoshmërisht që me në fund të miratojnë në grupet e tyre sa më parë materialet e domosdoshme për këto gje.

Në kuadrin e projekteve shkencore dhe artistike, gjatë këtij viti ka pasur shumë projekte të përbashkëta që janë realizuar si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

- **Workshop-e, master-class-e, Marrëveshje bashkëpunimi**

Një numër i rëndësishëm Master-Class-esh dhe Workshop-esh janë zhvilluar në mjediset e Universitetit tonë në të tre fakultetet, të cilat krahas projekteve artistike, janë organizuar nga vetë Universiteti i Arteve, si dhe në bashkëpunim me institucione artistike shqiptare dhe të huaja si dhe ambasada, me një pjesë të të cilave kemi firmosur marrëveshje bashkëpunimi si: Akademia Muzikore Liszt, Këshilli Britanik, Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, Teatri Kombëtar, TKOB, Instituti Italian i Kulturës, Ambasada e Hungarisë, Ambasada e Izraelit etj. E rëndësishme është që tashmë këto Master-class-e janë shtrirë edhe në fusha të studimit në të cilat ka pasur mungesa në këto shkëmbime të domosdoshme përvojë. Gjithashtu, këto janë realizuar edhe në fusha të artit që janë pak ose aspak të lëvruar në shkollën tonë duke i dhënë në këtë mënyrë një hapësirë më të madhe studentëve dhe pedagogëve, për të përftuar eksperiencë të reja.

Marrëveshjet me institucionet analoge prestigjioze ndërkombëtare që operojnë në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik janë një nga prioritetet e Universitetit të Arteve. Në këtë

kuadër vlen të veçohet nënshkrimi i marrëveshjes me Akademinë Muzikore Liszt në Budapest e cila është një nga institucionet e edukimit artistik më të njohura evropiane falë dhe historisë dhe traditës së pasur. Gjithashtu, janë hedhur bazat për fillimin e një bashkëpunimi me Universitetin Paris 8, i cili ka një fakultet artesh ku përfshihen të gjitha fushat ku ne operojmë, me Konservatorin Nacional Superior të Muzikës dhe Dancit të Parisit, Universitetin e Teatrit, Filmit Artistik e Televizionit në Budapest, etj. Në muajin mars do të vijë për vizitë Dekan i UFR-së Muzikë dhe Muzikologjisë në Universitetin Paris *Sorbonë* Prof. *Frédéric Billiet*, i cili në bashkëpunim me universitetin tonë do të mbajë një workshop. Nëpërmjet tij, pritet të realizohet edhe një marrëveshje bashkëpunimi afatgjatë ndërmjet dy institucioneve.

- Projektet artistike

Universiteti i Arteve ka një aktivitet të pasur e të ngjeshur artistik. Cilësia dhe profesionalizmi mbeten kriteri kryesor në realizimin e këtyre aktiviteteve. Në këtë kuadër, në Galerinë e FAB janë realizuar disa ekspozita individuale dhe të përbashkëta si dhe atelier me pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve të FAB si dhe në bashkëpunim me institucionet partnere ku mund veçojmë atë me Këshillin Britanik.

Po ashtu, në sallat e Universitetit të Arteve si dhe në sallën e TK, janë realizuar një numër i konsiderueshëm shfaqjesh teatrale, koreografike të drejtuara nga pedagogët e FAS. Një vend të rëndësishëm këtë vit ka zënë realizimi dhe shfaqja e filmave të studentëve të këtij fakulteti si dhe të studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe Tetovës. Po ashtu në bashkëpunim me Ambasadën Franceze dhe personalitete të artit francez janë realizuar bashkëpunime të rëndësishme në këtë fushë. Zgjedhja e ambienteve të Universitetit të Arteve për shfaqja e filmit "The Artist" (një film që ka fituar 5 Oscar, 3 Golden Globe, 7 çmime Bafta etj.) përbën një pikë kulmore që dëshmon edhe një herë seriozitetin dhe prestigjin që ky universitet ka fituar në sy të partnerëve tanë.

Koncertet e pedagogëve dhe studentëve të FM si çdo vit edhe në vitin që po lemë pas, kanë qenë të shumta jo vetëm në kuadër të stinës koncertore por edhe si aktivitete jashtë kësaj stine, në bashkëpunim me artistë shqiptarë dhe të huaj. Gjithashtu pedagogë dhe studentë të këtij fakulteti kanë qenë të angazhuar gjerësisht si solistë dhe pjesëtarë ansamblesh në projekte të organizuara nga institucione shtetërore dhe private. Stina Koncertore e Pranverës 2013 u zhvillua me një numër prej 21 koncertesh të studentëve dhe pedagogëve të FM. Në të morën pjesë 384 studentë dhe 80 pedagogë (të brendshëm dhe të ftuar) Festivali "Flauti Magjik" - katër koncerte me pjesëmarrjen e pedagogëve të brendshëm dhe të ftuar si dhe të studentëve të FM, në kuadrin e Stinës Koncertore të Pranverës 2013. Koncert i Ansambllit Barok, qershor 2013. Koncert i Orkestrës Frymore, qershor 2013. Memorandumi I bashkëpunimit me Adger University, Kristiansand, Norvegji, beri të mundur dërgimin e një studenti kitarist për studime Master me bursë të shtetit norvegjez. Në vitin në vijim planifikohet/n 1 ose dy bursa të tjera për studentët e FM. Në janar 2013 u zhvillua me studentët e klarinetës të FM

një masterclass dhe u realizua një emision televiziv me klarinetistin turk Hüsnü Şenlendirici në bashkëpunim me shoqatën Clarimpro. Në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin e

Muzikës në Salzburg në Maj 2013 u zhvillua një workshop tre ditor me Dr. Michael Malkiewitz, muzikolog.

Në qershor 2013 u zhvillua një masterclass me kompozitorin Aldo Shllaku, kompozitor i muzikës së filmit, Los Angeles, USA me temën "Mbi muzikën në film dhe zhvillimet teknologjike të muzikës në film". Morën pjesë studentë të kompozicionit dhe muzikologjisë.

Jane rivendosur kontaktet me CEEPUS për të filluar shkëmbimet e studentëve dhe pedagogëve të FM në kuadër të këtij programi.

Gjithashtu në bashkëpunim me AEC punohet për të themeluar një program studimi të World Music (muzike popullore, të lehtë, xhaz etj.).

Në bashkëpunim me Festivalin Pianodrom ku UART ishte partneri kryesor në periudhën Tetor-Dhjetor 2013, u zhvilluan pesë workshope për studentët e pianos me pianistët Marsel Worms (Hollandë), Dimitri Vasiliakis (Francë), Natalia Deva (Rusi), Mihail Dubov (Rusi) dhe Francesco Prode (Itali)

Në bashkëpunim me Tetorin Gjerman, u zhvillua një masterclass dy ditore me dirigjentin Desar Sulejmani me temën Shoqërimi i Liedit.

Në bashkëpunim me Universitetin e Adger, Norvegji, në tetor 2013 u zhvillua me studentët e pianos së FM një masterclass me Prof. Telef Juva nga Universiteti i Adger në Norvegji.

Vlen të theksohet angazhimi maksimal i pedagogëve por edhe i studentëve, në projekte madhore të organizuara nga vetë UART në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin Shtetëror të Tetovës me pjesëmarrjen e të tre fakulteteve siç është edicioni i vitit 2013, i ngjarjes artistike "Ura me tre harqe" ku UART ishte mikpritës. Publiku, kritika profesionale por mbi të gjitha mass-media tregoi një interes të jashtëzakonshëm në të gjitha realizimet artistike të tij. Paraqitja dinjitoze në këtë ngjarje të ngjeshur me aktivitete të shumëllojshme në të gjitha fushat e artit që në mbulojmë, tregoi edhe për një përgatitje të mirë dhe cilësi të larta menaxhuese të stafit akademik, joakademik e studentë të UART në organizime të tilla.

Një numër i madh aktiviteteve janë realizuar në rrethe të ndryshme si dhe në festivale kombëtare e ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit. Paraqitja dinjitoze në eventet kombëtare dhe ndërkombëtare, është një publicitet mjaft i mirë në rritjen e interesit dhe afrimin e kandidatëve për të studiuar në programet që Universiteti ynë ofron.

Universiteti i Arteve gjatë vitit 2013 është përfshirë në një projekt ndërkufitar IPA ADRIATIC CROSSBORDER me partnere nga 4 shtete: Italia, Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria.

Projekti i titulluar ArTVision - A live Art Channel ka për lider partner Rajonin e Puglias dhe ky partneritet shtrihet me Fondacionin Pino Pascali, Rajonin e Venetos, Accademia delle Belle Arti di Venezia, Qarkun e Primorje Gorski Kotor dhe Kanal Ri Kroaci, Ministrinë e Kultures dhe Fakultetin e Artit Dramatik Mali i Zi dhe Ministrinë e Kultures dhe Universitetin e Arteve Shqiptare. Kohezgjatja e projektit është 30 muaj. Projekti ArTVision në vetvete është një platformë komunikimi për artin bashkëkohor përmes një sistemi difuzioni transmedial, e cila përfshin formate e linje editoriale të përcaktuara në bashkëpunim me të gjithë partnerët me qëllim pasqyrimin dhe shfrytëzimin e produksioneve audiovizuale të prodhuara përgjatë jetës së projektit. Element kyç i këtij projekti është pjesëmarrja e artisteve të rinj në këto produksione si dhe përfshirja e tyre në punën reale të figurave të ndryshme profesionale që lidhen me botën e produksioneve audiovizuale.

Krijimtaria artistike bashkekohore e artisteve shqiptare do te krijoje vizibilitet me te zgjeruar permes ketyre produkteve audiovizuale ne nje rrjet televizionesh, webtv, festivalesh, ekspozitash etj. ne hapesiren qe perfshin jo vetem programi IPA ADRIATIC CROSSBORDER, por edhe per nje publik me te gjere, duke pasur parasysh perdorimin e teknologjise se komunikimit dhe lancimin edhe permes rrjeteve sociale.

- **Mbështetja e pedagogëve, studentëve dhe artistëve në projektet e tyre**

Në mënyrë që Universiteti i Arteve të vazhdojë të jetë jo vetëm institucion i edukimit artistik por edhe në një qendër të prodhimit të vlerave artistike edhe këtë vit, Universiteti i Arteve ka ofruar sistematikisht, mbështetje dhe bashkëpunim me artistë shqiptarë të cilët punojnë në këtë institucion dhe jashtë tij. Partneriteti dhe bashkëpunimi me Festivale serioze dhe cilësore ndërkombëtare, është vetëm një nga aspektet e tij. Këto aktivitete e bashkë me ato periodike që theksuam më sipër, janë vlerësuar nga kritika por edhe janë pasqyruar gjerësisht në mass-media duke kthyer këtë Universitet në një qendër prodhimi dhe konsumimi të vlerave të vërteta artistike dhe profesionale. Prania e publikut i cili këtë vit kapi një shifër rekord, është një tregues i qartë për këtë.

- **Kualifikimi i personelit akademik,**

Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit akademik dhe jo akademik ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e UART. Këtë vit ka qenë i madh numri i personelit akademik që ka avancuar në përfitimin e titujve dhe gradave shkencore. Vlen të theksohet se Universiteti ynë ka përfituar numrin më të madh të titujve akademik krahasuar me universitetet e tjera të vendit si nga pikëpamja sasiore ashtu edhe cilësore. Ky avancim i rëndësishëm në kualifikimet shkencore të personelit akademik dhe atij ndihmës do të luajë një rol më të madh jo vetëm në rritjen e prestigjit të institucionit tonë por edhe në realizimin më të mirë të procesit mësimor, krijues e në edukimin qytetar të studentëve tanë si një nga detyrat e rëndësishme që ligji na ngarkon.

KREU I TRETË

BIBLIOTEKA SHKENCORE

Biblioteka e Universiteti Arteve për të përmbushur misionin e saj si mbështetëse e procesit mësimor dhe të funksionojë si qendër arti në gjithë vendin, ka punuar në baza të një strategjie të caktuar për shërbimet, pasurimin e koleksioneve të saj dhe vazhdimësinë në krijimin e rekordeve bibliografike online dhe të arkives digjitale si dhe në ngritjen profesionale të punonjësve të kësaj biblioteke në vazhdimësi.

Duke u mbështetur në punën sistematike, etiken profesionale, disiplina dhe përgjegjshmëria e lartë të punonjësve të kësaj biblioteke munda të përballojë këto vite të vështirë ekonomike për të përmbushur misionin e saj si mbështetëse e procesit mësimor dhe si qendër informacioni për artin.

Në vijim përshkruhet rritja e koleksioneve dhe shërbimeve të bibliotekës gjatë vitit 2013.

1. Rritja e koleksioneve të printuara në bibliotekë gjatë 2013

Pasurimi i koleksioneve të bibliotekës sonë është bërë duke ndjekur një politikë sa më ekonomike për arsye të vështirësive ekonomike që kalon vendi dhe bota.

Pasurimi i koleksioneve të bibliotekës është bërë në baze të një politikë të caktuar:

- duke ndjekur programet mësimore, aktivitete artistike që mbështet Universiteti i Arteve.
- duke studiuar me kujdes të gjitha degët ekzistuese dhe degët e reja në çdo fakultet duke evidentuar mungesat më të mëdha që kemi pasur në këto koleksione në bibliotekë dhe është arritur duke bashkëpunuar ngushtë me stafin akademik të çdo fakulteti dhe rektoratin
- nevojat në rritje të përdoruesve të bibliotekës

Pasurimi gjatë viti 2013 është arritur:

- Nëpërmjet: huazimeve ndër - bibliotekare dhe individëve, shkarkime nga interneti dhe nga biblioteka digjitale si Aleksander Street Press, Cambridge dhe EbscoHOST dhe shumëfishime nëpërmjet fotokopjes.
- Pasurimi i fondit të bibliotekës për këto vite është vetëm nga donacionet e huaja dhe autoreve shqiptare.

Pasurimi me koleksion të printuar dhe elektronik:

- Nga donacionet dhe dhuratat nga autorët libra 82 libra dhe shqip dhe në gjuhë të huaja, arti vizual dhe parte muzikore.
- Janë fotokopjuar dhe printuar 20 drama të reja, 60 vepra të ndryshëm muzikore, simfoni, opera, sonata dhe koncerte. Gjithsej 10 000 faqe nga të cilat: 140 vepra nga të cilat 120 vepra muzikore (parte instrumentale dhe parte dhe partitura orkestrale) dhe 20 janë drama dhe përkthime.

- Riparimi i librave të dëmtuar nga përdorimi
- Burimet elektronike
- Nëpërmjet anëtarësimit në EIFL dhe projektit Era 2012 kemi akses tek baza e të dhënave, biblioteka dixhitale.
- Cambridge Journal on line
- Zgjerimi i arkives të vogël për dramën dhe partiturat muzikore digjitale.
- Krijimi i arkives me rritjen e fondi audio pdf dhe skanime.

Në ndihmë të rektoratit dhe të fakulteteve janë bërë Printime dhe Fotokopime për Universitetin si: Rektoratit, Fakulteti i Arteve Pamore, Burimet Njerezore, Degës së Investimeve, Fakulteti i Muzikës dhe i Artit Skenik kur ka pasur defekt në fotokopjen ose mungesën e tonerave të tyre. Janë bërë **300** lidhje dokumentesh për rektoratin dhe të tre fakultetet si dhe të gjitha partiturat dhe partiturave për procesin mesimor. Janë fotokopjuar dhe printuar rregullorë, evidenca, statistika, materialet e senatit, teste provimesh, leksione, programe, ligje, vendime, formularë, drama, dega e investimeve, materialet e MASH, rregullore, etj.

2. Shërbimet që ofron biblioteka për përdoruesit e saj

Shërbimi në Bibliotekën e Universitetit të Arteve gjatë 2013 është bërë nëpërmjet:

a. Fondit të mbyllur


Ky shërbim është kryer i shpejt dhe cilësor për të tre fakultetet por kryesisht për Fakultetin e Muzikës dhe Artit Skenik pasi librat e arteve pamore shërbejnë në fondin e hapur

Përdorues të fondit të mbyllur janë 1000 anëtarë.

Kemi hedhur në katalogun elektronik në Sistemin e Integruar Open Source "Koha", hyrjet e vitit 2012 - 2013 dhe librat e fondit të hapur.

Disponojmë 2300 rekorde bibliografike në katalogun online (universiteti i arteve/biblioteka/katalogu on line)


Numri i përdoruesve të Bibliotekës gjatë vitit 2013 ishte 1000 përdorues.



b. Fondit Audio


Salla multimediale ka pasur 90 – 100 pederuese ne dite.

Krijimi i arkives mesimore digjitale –



Krijimi i bazes se te dhenave me rekorde te muzikes shqiptare dhe boterore si dhe te fondeve speciale te Arkives Mesimore Digjitale si tema diplomash nder vite, artikuj studimor dhe materiale promocionale, etj.

- **Statistika mbi aksesimin ne kete Arkive Mesimore Digjitale nga shume vende te botes.**



Disponohen mbi 2294 rekorde ne audio dhe tekst te plote ne Arkiven Digjitale.

c. Fondit te hapur

Ky fond ofron koleksionet e arteve pamore, materialet referenciale për te tria fakultete, kompjuter dhe fotokopje. Fondi i hapur i librave i jep mundësinë përdoruesve te bibliotekës te shfrytëzojnë pa limit librin qe dëshiron dhe duke fotokopjuar faqet qe ju intereson. Vendosija e 5 kompjuterave (kane akses ne internet, jane instaluar programet specifike te te gjitha degeve te artit) te rinj te mbeshtetur nga Projekti i I i UNILAB-it ka bere qe kjo salle shfrytëzohet ne maksimum nga përdoruesit e saj.

Kjo sallë përdoret nga 35 – 40 perdorues ne dite

Pikat e forta dhe te dobëta për realizimin e këtij misioni gjate punës ne vitin 2013

Pikat e forta:


- Etika dhe përgjegjshmëria e larte profesionale e punonjësve te bibliotekës
- Disiplina gjate orarit te punës
- Aftësia për te puna ne grup e stafit te bibliotekës
- Duke u udhëhequr nga moto se asnjë përdorues i bibliotekës te mos dali pa një informacion ose orientim rreth materialeve te kërkuar
- Ngritja profesionale e punonjësve te BSHUA. Profesionit i bibliotekareve, si punonjës qe merren me dhënie dhe përpunim informacioni, kërkon ngritjen profesionale te tyre ne vazhdimësi.



Arritjet gjate 2013

1. Prezantimi i arkives mesimore dhe katalogut on line – Sistemi i digjitalizimit “Dspase” – Sistemi i automatizimit “ KOHA”.

- Krijimi i katalogut on line
- Arkives mesimore digjitale

Vazhdimi i krijimit te katalogut on line dhe arkives digjitale si dhe perdorimi i tyre ne rritjes nga perdoruesit.





Ky prezantim solli:

- Familjarizimin e përdoruesve të bibliotekës me këto sisteme
- Promovimin e Bibliotekës sonë në implementimin e teknologjive të reja të informacionit vendin tonë dhe jashtë saj
- Promovimin e Universitetit të Arteve nepermjet shtypit dhe medias

3. Kualifikim i metejshem i stafit te bibliotekes

- Kurs kualifikimi 1 vjecar mbi teknologjine e re te informacionit i dy punonjësve (klasifikatores dhe bibliografes
- Pjesemarrje ne disa konferenca dhe workshope kombetare dhe nderkombetare mbi teknologjine e re te informacionit

Pikat e dobëta:


- Kriza ekonomike globale, uljen e donacioneve dhe mos blerje te librave nga Universiteti per kete biblioteke. Fondacionet dhe ambasadat per shkak te krizes mbeshtesin shtresat e margjinalizura.
- Mungesa e nje skaneri portabel per skanimin e doreshkrimeve te vjetra te demtuara qe te rritet numri i materialeve te digjitalizuara.
- Mos gjetja e fondeve neper fondacione te ndryshme e nje projekti shtese per mirembajtjen dhe zhvillimin e sistemeve te bibliotekes.

Objektivat për te vitin 2014

- Krijimin e rekordeve ne katalogut online me sistemin e integruar "KOHA" per fondet retrospektive si dhe per arkiven digjitale
- Abonim ne baza te dhenash elektronike si Jstor, Aleksander Street Press qe jane shume te domosdoshme pre procesin mesimor dhe te kerkuara ne menyre te vazhdueshme nga perdoruesit tane.
- Projekte per mbeshtetjen ne mirembajtjen dhe zhvillimin e sistemeve ne biblioteke.

KREU I KATËRT GALERIA FAP

Galeria FAP, i zhvilloi aktivitetet e saj kryesisht përgjatë kalendarit të vitit akademik. Numri i aktiviteteve përgjatë kësaj kohe arriti në 22, nga të cilat 5 aktivitete ishin me pagesë, 4 ishin të ftuar nga Fakulteti i Arteve të Bukura, dhe pjesa tjetër aktivitete të brendshme të Fakultetit si ekspozita pedagogësh, ateliesh, apo ekspozita mikse si “Ura me 3 Harqe”, një bashkëpunimin mes tre shkollave të artit shqipëfolëse.



Frekuentueshmëria e saj varioi në rreth 300 vizitorë për aktivitet, prej të cilëve 20 % janë pedagogë, 50 % studentë dhe 30 % artëdashës.

Pasqyrimi i aktivitete në media e shkruar dhe audio vizive ka qenë maksimal, duke pasur parasysh që për secilin prej tyre njoftohen në mënyrë direkte dhe elektronike mbi 25 gazetarë.

Në një vit kalendarik, galeria arriti një numër maksimal vizitorësh në rreth 5000 persona.

Fondi i Fakultetit të Arteve të Bukura është aktivizuar në këtë vit akademik dy herë, për ekspozitën “Vizatime ‘60-‘80”, kuruar nga Ermir Hoxha dhe “Majlinda Forever”, kuruar nga Ermir Hoxha dhe Arben Bajo. Të dy ekspozita u realizuan me punime të Fondit të FAB, për tu rikthyer në vendin e mëparshëm pas aktivitetit. Një pjesë e arkivit të Fondit të FAB është shfrytëzuar dhe për dekorimin e mjediseve të brendshme të Universitetit të Arteve, proces i cili është kryer sipas rregullores, me marrveshje të ndërsjellta, përcaktuar në kontrata dypalëshe. Për përmisimin dhe shfrytëzimin maksimal të Fondit u krye dhe një projekt mbi rivitalizimin dhe një konservimin më të mirë të produktit të Fondit. Projekti i shoqëruar dhe me preventivin financiar përkatës është në pritje të një financimi të mundshëm. Gjatë gjithë vitit akademik bashkëpunimi me strukturat e tjera të Universitetit të Arteve ka qenë i kënaqshëm edhe pse mbetet gjithnjë problem i mprehtë një financim konsistent për përmisimin e sistemit të ndriçimit në Galerinë FAB, si dhe për përmisimin e kushteve të ruajtjes dhe promovimit të Fondit të FAB.

Projektet e Galerise FAB për vitin akademik 2012 – 2013, ishin si më poshtë:

1-2 nëntor 2012	Miqte e Ujit, aktivitet
6 – 13 nëntor 2012	Vizatime ‘60-‘80, ekspozitë e realizuar me punime të zgjedhura nga Fondi i FAB, kurator Ermir Hoxha
15 -22 nëntor 2012	Agim Ramadani, solo show ekspozitë personale e heroit të UÇK
24-2 dhjetor 2012	Udhët 2, ekspozitë e realizuar me punimet e zgjedhura nga krijimtaria e pedagogëve të FAB

4 – 14 dhjetor 2012	Majlinda Kelmendi, solo show, pegagoge e ftuar nga Fakulteti i Prishtinës
15 -24 dhjetor 2012	Fahredin Spahija, solo show, fotograf i ftuar nga FAB
5 janar – 15 janar 2013	Të gjithë mbi një qiell, grup artistësh të rinj,
25 janar – 3 shkurt 2013	Sfida Everest, ekspozitë fotografike Fation Plaku,
12 shkurt - 19 shkurt 2013	Vladimir Llakaj, ekspozite personale Pedagog i skulptures
1 – 7 mars 2013	Agnes Muharremi, ekspozitë personale, e ftuar si pedagoge e Fakultetit të Arteve, Prishtinë
10 – 14 mars 2013	Roland Tasho, ekspozitë personale
15 – 17 mars 2013	Ambasada Franceze ekspozite me fotografi
22 mars– 04 prill 2013	Atelieri i Multimedias,
10 – 17 prill 2013	Majlinda Forever, ekspozitë e kuruar nga Arben Bajo e Ermir Hoxha
25 – 30 prill 2013	Societe generale, ekspozitë personale
8 maj – 18 maj 2013	Grafika, atelier
20 – 24 maj 2013	Ura me Tre Harqe, ekspozitë në grup, Universiteti i Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës
25 – 31 maj 2013	Atelieri Tekstilit, kurator Najada Hamza
2 qershor – 9 qershor 2013	Instituti Italian i Kulturës, ekspozitë në grup, kurator Stefano Romano
15 qershor – 22 qershor 2013	Street art, ekspozitë nga Ardian Isufi dhe Genc Përmeti, pedagogë në FAB
25 qershor – 26 qershor 2013	Viti i I, ekspozitë atelieri Skulptura në Hapsirat publike, kuruar nga Artan Peqini
28 qershor – 15 korrik 2013	Diplomat: Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Fakulteti i Artit Skenik
5 janar – 15 janar 2013	Të gjithë mbi një qiell, grup artistësh të rinj,

25 janar – 3 shkurt 2013	Sfida Everest, ekspozitë fotografike Fation Plaku,
12 shkurt - 19 shkurt 2013	Vladimir Llakaj, ekspozite personale Pedagog i skulptures
1 – 7 mars 2013	Agnes Muharremi, ekspozitë personale, e ftuar si pedagoge e Fakultetit të Arteve, Prishtinë
10 – 14 mars 2013	Roland Tasho, ekspozitë personale
15 – 17 mars 2013	Ambasada Franceze ekspozite me fotografi
22 mars– 04 prill 2013	Atelieri i Multimedias,
10 – 17 prill 2013	Majlinda Forever, ekspozitë e kuruar nga Arben Bajo e Ermir Hoxha
25 – 30 prill 2013	Societe generale, ekspozitë personale
8 maj – 18 maj 2013	Grafika, atelier
20 – 24 maj 2013	Ura me Tre Harqe, ekspozitë në grup, Universiteti i Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës
25 – 31 maj 2013	Atelieri Tekstilit, kurator Najada Hamza
2 qershor – 9 qershor 2013	Instituti Italian i Kulturës, ekspozitë në grup, kurator Stefano Romano
15 qershor – 22 qershor 2013	Street art, ekspozitë nga Ardian Isufi dhe Genc Përmeti, pedagogë në FAB
25 qershor – 26 qershor 2013	Viti i I, ekspozitë atelieri Skulptura në Hapsirat publike, kuruar nga Artan Peqini
28 qershor – 15 korrik 2013	Diplomat: Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Fakulteti i Artit Skenik

KREU I PESTË DEGA MËSIMORE

Gjatë kësaj periudhe, puna e Degës Mësimore dhe Zhvillimit të Kurikulave është fokusuar në:

- ndjekjen e të gjitha problemeve të fushës akademike në Universitetin e Arteve në bashkëpunim të ngushtë me zëvendës rektorin për anën mësimore;
- ndjekjen me rigorozitet të zhvillimit të kurikulave, në lidhje të ngushtë me Fakultetet, në përputhje me: Vendimet e Këshillit të Ministrave; Urdhrat dhe Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve; Statutin e Universitetit të Arteve; Vendimet dhe Urdhrat e Senatit; Vendimet, Urdhrat dhe Udhëzimet e Rektorit, etj.
- bashkëpunimin me Dekanët, zëvendës dekanët, përgjegjësit e Njësive Bazë të Fakulteteve për menaxhimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor në UART;
- kontrollin e respektimit të procesit mësimor në UART;
- mbledhjen, përpunimin, analizën, ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me procesin mësimor dhe zhvillimin e kurikulave në të tre fakultetet e UART;
- raportimin për gjithçka që lidhet me procesin mësimor dhe zhvillimin e kurikulave Rektorit dhe zëvendës rektorit të anës mësimore të Universitetit të Arteve.

Më poshtë po raportojmë përmbledhtas punën e realizuar nga Dega Mësimore dhe Zhvillimit të Kurikulave

Prill 2013

- Grumbullimi i dokumentacionit të të tre fakulteteve që lidhen me procesin mësimor në vijim 2012-2013:
 - Struktura mësimore;
 - Planet e ngarkesës mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar;
 - Oraret mësimore, etj.
- Nxjerrje dhe përpunim të dhënash statistikore dhe financiare, dhe plotësimi i Tabelës: „Planifikimi i detajuar i Llogarisë 600.6 (paga dhe shpërblime) për vitin 2011-2012“:
 - Zbërthim dhe analizë e të dhënave të Ngarkesave mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar për të tre fakultetet FAS, FAB, FM për vitin akademik 2011-2012: Norma dhe mësimdhënie e normuar, në të dy ciklet e studimit;
 - Verifikim i tabelës së ngarkesës së realizuar nga stafi akademik për vitin akademik 2011-2012 (sipas Formatit të Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik 2011-2012).
- Krijim dhe ndjekje e procedurës së verifikimit të autenticitetit të dokumentacionit të lëshuar ndër vite nga institucioni ynë (ish-Instituti i Lartë i Arteve; ish-Akademia e Arteve; sot: Universiteti i Arteve); Përgjigje kërkesave të të interesuarve për këtë shërbim. **Punë e përmuajshme.**
- Sistemim i të dhënave të ngarkesave mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar për vitin 2012-2013 të tre fakulteteve FAS, FAB, FM, sipas dy Cikleve të studimit, duke nxjerrë totalin e orëve të konvertuara si dhe normën vjetore.

Maj 2013

- Krijim dhe përditësim i Arkivës së Degës Mësimore me të dhëna rreth personelit akademik të UART:
 - kategoria e punës;
 - titulli akademik;
 - titullar lënde, etj.
- Sistemim i dokumentacionit në Degën mësimore të Urdhrave mbi regjistrimin e titujve shkencorë.

- Përpunim analitik i evidencave të ngarkesave mësimore të tre fakulteteve në një Bazë të vetme të dhënash për të krahasuar zërat:
 - orë faktike;
 - orë të konvertuara të parashikuara (të programuara) nga ngarkesat mësimore për çdo pedagog të brendshëm dhe të ftuar;
 - orë të realizuara (zë që do të plotësohet në përfundim të procesit mësimor 2012-2013).
- Verifikimi pranë sekretarive mësimore të fakulteteve për procedurën e: afishimit të datave të provimeve të mbartura, konstituimit të komisioneve të provimeve, caktimit të sallave ku do të organizohen provimet.
- Riformatim i Evidencës për plotësimin e orëve të mësimin për vitin akademik 2012-2013 nga personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar;
- Komunikim me Përgjegjësit e Njësive dhe k/sekretaret mësimore të tre fakulteteve (me dokument shkresor dhe via-email) për: pajisjen e personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar me formatin e ri të Evidencës (duke ua dorëzuar via email dhe dorazi), si edhe, informimin e çdo pedagogu për afatin e dorëzimit të Evidencës: 15 qershor 2013.

Qershor 2013

- Përpunimi dhe pasurimi me detaje i tabelës së Vërtetimit „Mbi llogaritjen e realizimit të normës mësimore në ciklin e parë Bachelor dhe në ciklin e dytë Master“ që shoqëron evidencën e ngarkesës mësimore të çdo pedagogu; dhe dorëzimi i saj Përgjegjësve të Njësive bazë të tre fakulteteve.
- Konsultimi me Degën e Burimeve Njerëzore për Përpunimin e Rregullores së Degës Mësimore dhe Zhvillimit të Kurrikulave.
- Zbatimi i Urdhrit të Rektorit nr. 27, dt. 07.06.2013, “Për ushtrimin e kontrollit në fakultete për mbarëvajtjen e procesit të provimeve”:
 - Verifikimi i zbatimit të procedurës ligjore për organizimin dhe zhvillimin e provimeve për vitin akademik 2012-2013, në tre fakultetet e UART;
 - Kontroll i përditshëm gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të provimeve (15 qershor-15 korrik) sipas kalendarit zyrtar të miratuar për çdo fakultet;
 - Verifikim i dokumentacionit zyrtar: fletët e provimit; tezat e sekretuara;
 - Evidentimi i çdo problematike të krijuar dhe monitorimi i zgjidhjeve rast pas rasti;
 - Relatimi i përditshëm në grupin e punës ngritur nga Rektori;
 - Përpilimi i relacionit përfundimtar për Rektorin e UART.
- Kontroll i hollësishëm i Evidencave të ngarkesës mësimore të personelit akademik të ftuar (dorëzuar nga tre fakultetet) dhe krahasimi me tabelën e ngarkesës mësimore të planifikuar në fillim të vitit akademik:
 - përlllogaritja e orëve faktike dhe orëve të konvertuara, rast pas rasti;
 - evidentimi i mospërputhjeve në shifra në vërtetimet bashkëngjitur dhe kthimi për korrigjim.
- Përpilimi i Listë-Pagesës me të gjitha detajet e kërkuara për Drejtorinë e Financës.
- Ballafaqimi i Listës së punonjësve mësimorë të ftuar me Kontratat e tyre të Punës për vitin akademik 2012-2013, për të verifikuar informacionin lidhur me numrin e orëve faktike të realizuara prej tyre në vitet e ndryshme të dy cikleve të studimit si edhe numrin e orëve të konvertuara sipas Udhëzimit Nr. 20, dt. 09.05.2008, Udhëzimit Nr. 40, dt. 08.12.09, Udhëzimit Nr. 25, dt. 02.08.2010. .
- Kthimi i Evidencave të ngarkesës mësimore të punonjësve për argumentim nga ana e përgjegjësve të Njësive Bazë, në rastet e konstatimit të mospërputhjes së orëve të realizuar me orët e planifikuara.
- Verifikimi dhe përditësimi i informacionit rreth ndryshimeve në kategori dhe tituj akademikë të punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar; me Degën e Burimeve Njerëzore, Sektorin e statistikës dhe Drejtorinë ekonomike e UART.

- Përpunimi i tabelës përmbledhëse me të dhënat e tre fakulteteve për Planifikimin e buxhetit për vitin akademik 2013-2014:
 - Numri i punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar për çdo fakultet, sipas kategorive;
 - Numri i orëve mësimore në ngarkim të punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar për çdo fakultet, sipas kategorive;
 - Numri total i punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar dhe i orëve mësimore që kanë në ngarkim sipas kategorive.

Korrik 2013

- Verifikimi dhe përditësimi i të dhënave me zyrën e statistikës për Evidencën e Punonjësve mësimorë efektivë për vitin akademik 2012- 2013.
- Verifikimi i Listës emërore të studentëve të UART dhe rezultateve të tyre në Testin Ndërkombëtar të Anglishtes pranë agjencive të licencuara për ta dhënë këtë shërbim; komunikimi me sekretariatë mësimore të tre fakulteteve; përditësimi i informacioneve; krijimi i regjistrimit të rezultateve të TNA (i unifikuar për të tre fakultetet), me të gjitha zërat e nevojshëm.
- Përfundimi i llogaritjeve dhe përpilimi i Listë-Pagesës nr. 1 të punonjësve mësimorë të ftuar për tre fakultetet e UART; dorëzimi i saj kryetares së DMZHK.
- Verifikimi i të gjitha zërave të Listë-Pagesës nr. 1 të punonjësve mësimorë të ftuar; kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë në hedhjen e të dhënave: orë faktike, orë të konvertuara, në çdo vërtetim të Llogaritjes së realizimit të normës mësimore në ciklin e parë Bachelor dhe ciklin e dytë Master të çdo punonjësi mësimor të ftuar; dorëzimi i tyre zëvendës rektorit për anën mësimore.
- Përpilimi i Listës së punonjësve mësimorë të ftuar që nuk kanë dorëzuar pranë DMZHK Evidencën për Plotësimin e orëve mësimore për vitin akademik 2012-2013; përcjellja e listës përgjegjësve të Njësive bazë të tre fakulteteve; duke u kërkuar që të marrin të gjitha masat që punonjësit mësimor të ftuar të përmbushin detyrimin ligjor për të dorëzuar Evidencat.
- Sistemi i dokumentacionit arkivor të DMZHK; klasifikimi i vërtetimeve të Llogaritjes së realizimit të normës mësimore në ciklin e parë Bachelor dhe ciklin e dytë Master të punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar për vitin akademik 2011-2012.

Gusht 2013

(1-10 gusht)

- Bashkëpunimi me Degën e investimeve të UART për përpunimin e të dhënave që lidhen me procesin mësimor, në dobi të Projektit të ndërmarrë nga Dega e investimeve për mirëmenaxhimin e ambjenteve të UART; krijimi i tabelave përmbledhëse për tre fakulteteve.
- Përpilimi i Listë-Pagesës nr. 2 të punonjësve mësimorë të ftuar që kanë dorëzuar Evidencën për Plotësimin e orëve mësimore për vitin akademik 2012-2013.

(15-31 gusht)

- Njohja me Udhëzimin e ministrit të MASH Nr. 35, dt. 05.08.2013 „Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja në programet e ciklit të parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2013-2014“; ndjekja e zbatimit të këtij procesi pranë sekretarive mësimore; ndjekja e respektimit të afateve zyrtare dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin.
- Njohja me Udhëzimin e MASH Nr. 39, dt. 14.08.2013 „Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në Institucionet Publike të

- Arsimit të Lartë si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2013-2014"; ndjekja e zbatimit të këtij procesi pranë sekretarive mësimore; ndjekja e respektimit të afateve zyrtare dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin.
- Formulimi i Njoftimit zyrtar të UART për transferimin e studimeve në vite të ndërmjetme, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2013-2014; dorëzimi në sekretaritë mësimore të fakulteteve; afishimi në çdo fakultet.
 - Përpilimi i Formularit të aplikimit për transferimin e studimeve në vite të ndërmjetme, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2013-2014; dorëzimi në Degën e Burimeve Njerëzore.
 - Njohja me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 565, dt. 27.06.2013 mbi „Kuotat e pranimit dhe tarifrat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë për vitin akademik 2013-2014“; kontaktimi me k/sekretaret mësimore; verifikimi i afateve zyrtare të inicimit dhe përfundimit të procesit dhe detyrimeve që rrjedhin e që duhen respektuar.
 - Njohja me Udhëzimin Nr. 17, dt. 17.07.2013 „Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2013-2014“; kontaktimi me k/sekretaret mësimore; verifikimi i afateve zyrtare të inicimit dhe përfundimit të procesit dhe detyrimeve që rrjedhin e që duhen respektuar.
 - Njohja me Shkresën e Agjencisë Kombëtare të Provimeve Nr. 525/2, dt. 14.08.2013, me Listat e konkurrentëve; kontaktimi me k/sekretaret mësimore; verifikimi i afateve zyrtare të inicimit dhe përfundimit të procesit dhe detyrimeve që rrjedhin e që duhen respektuar.
 - Ndjekja e procedurës së „Regjistrimit të formës së diplomave të ciklit të dytë ‚master Profesional‘ dhe ciklit të dytë ‚Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura‘ në Universitetin e Arteve të Tiranës“ dhe „Regjistrimit të formës së diplomave ‚Master i Nivelit të Dytë‘ (MND) në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve“ në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave; komunikimi me Kancelaren për përfundimin e procedurës së pagesave për çdo program studimi, kusht për pajisjen me Numër Identifikimi të Diplomave.
 - Regjistrimi në arkivën e DMZHK dhe verifikimi i dokumentacionit zyrtar të tre fakulteteve, miratuar në Senatin e UART: Struktura mësimore/kurikulat; planet e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2013-2014.
 - Monitorimi i procesit të konkurseve të pranimit në UART, sipas planit të punës të përpiluar nga grupi i monitorimit të zhvillimit të konkurseve të pranimit, që zhvillohen në UART për vitin akademik 2013-2014, i ngritur me Urdhrin e Rektorit Nr. 56, dt. 30.08.2013.
 - Përpunimi i pjesës së mbetur të Evidencave të realizimit të orëve mësimore, dhe përditësimi i Listë-Pagesës nr. 2 të punonjësve mësimorë të ftuar për vitin akademik 2012-2013.
 - Në vijim të procesit të unifikimit të dokumentacionit zyrtar të tre fakulteteve të UART: përpunimi i formatit të ri excel të hedhjes së informacionit për Strukturën mësimore të FM (Modulet, grup-lëndët). Kampion: Programi i studimit Piano (Interpretim) dhe Programi i studimit Pedagogji muzikore (KMD). (20 gusht - 9 shtator).

Shtator 2013

- Bashkëpunimi me Degën e investimeve të UART për implementimin e Projektit të ndërmarrë nga Dega e investimeve për mirëmenaxhimin e ambienteve të UART; Grumbullimi i të dhënave nga fakultetet.

- Kontakte me k/sekretaret mësimore dhe administratorët e fakulteteve për parashikimin e regjistrave mësimorë; **rakordim** për parametrat e faqesjes për reflektimin e informacionit të duhur, cilësinë e letrës, etj.
- Kontakte me përgjegjësit e njësive bazë, sekretaritë mësimore në tre fakultetet për koordinimin e datave të provimeve të vjeshtës për pedagogët e lëndëve teorike, për të mos patur përplasje në data dhe orë.
- Verifikimi i Kalendarit të provimeve të sezonit të vjeshtës, në tre fakultetet.
- Përpunimi i pjesës së mbetur të Evidencave të realizimit të orëve mësimore, dhe përditësimi i Listë-Pagesës nr. 2 të punonjësve mësimorë të ftuar – **punë e përditshme**.
- Verifikimi i listave me rezultatet e konkursit të ciklit të parë të studimeve Bachelor.
- Verifikimi i respektimit të afateve të hedhjes së rezultateve të konkursit 2013-2014 sipas sistemit matura online.
- Trajnim për Modulin e Kërkimit shkencor në Universitetet dhe Institutet e Kërkimit – implementim i platformës SW „UGOV Albania“ nga konsorciumi italian CINECA dhe Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik.
- Monitorim i përditshëm i procedurës së transferimit të studimeve; regjistrimet; kontrolli i dokumentacionit të dosjeve; kontakte me sekretaritë mësimore.
- Verifikimi në sekretaritë mësimore i rezultateve përfundimtare të studentëve të diplomuar në sezonin e provimeve të qershorit 2013.
- Verifikim i dokumentacionit (VKM 744, dt. 05.09.2013 “Për Kuotat dhe tarifat e shkollimit në IPAL për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë „Master Profesional“, „Master Shkencor“, „Master i Arteve të Bukura“ për vitin akademik 2013-2014) që rregullon proceduarit e studimit në ciklin e dytë Master në UART.
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e procedurës së pranimit dhe regjistrimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, „Master Profesional“, „Master Shkencor“, „Master i Arteve të Bukura“ për vitin akademik 2013-2014.
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e finalizimit të procedurës së „Regjistrimit të formës së diplomave të ciklit të dytë, Master Profesional, Master i Shkencave/Master i Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve të Tiranës“ dhe „Regjistrimit të formës së diplomave MND në Fakultetin e Muzikës“ në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Çertifikatave; **Paisja** me numrat e identifikimit të Diplomave.
- Përpunimi i Formatit të unifikuar të Listës së **notave** që shoqëron **Diplomën** e ciklit të dytë Master (Sipas Udhëzimit të MASH-it Nr. 15, dt. 04.04.2008 „Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë“, Shtojca 2).
- Ndjekja e përditshme e procesit të regjistrimit të fituesve të konkursit të raundit të parë, faza e parë.;
- Ndjekja dhe monitorimi pranë fakulteteve i procedurave të konkurseve të pranimit për ciklin e dytë të studimeve; Përgatija e formatit të unifikuar për „Konstituimin e Komisioneve të Masterit nga dekani i fakultetit“.
- Kontakte me fakultetet për kuotat e transferimeve dhe programeve të dyta të studimit.
- Verifikime (22-24,27-30 shtator) të Testit ndërkombëtar të anglishtes pranë agjencive të akredituara.
- Verifikim i Suplementit të Diplomës Bachelor; **ecuria** e plotësimit të suplementit; **plotësimi** i pjesës në anglisht.
- Verifikim në sekretaritë mësimore të fakulteteve të rezultateve përfundimtare të studentëve të diplomuar Bachelor në sezonin e provimeve të vjeshtës 2013.
- Monitorim i përditshëm pranë sekretarive mësimore i procesit të regjistrimeve për Konkursin e Masterit.

Tetor 2013

- Verifikimi pranë sekretarive mësimore i procesit të regjistrimit të fituesve për vitin akademik 2013-2014 në programet me kohë të plotë, raundi i parë, faza e dytë.;

- Ndjekja e procedurës së matkulimit të studentëve të ciklit I dhe II të tre fakulteteve; **verifikimi** i listës së studentëve pa nr. Matkulimi.
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e procesit të regjistrimit të aplikantëve fitues në programin e studimit të Ciklit të dytë „Master i Arteve të Bukura“, „Master Shkencor“, „Master Profesional“ për vitin akademik 2013-2014.
- Kontrolli i Evidencave të pedagogëve të ftuar; **komunikimi** me sekretaritet për vonesat.
- Verifikimi pranë Njësive bazë në tre fakultetet i ecurisë për plotësimin e Suplementeve të diplomës Bachelor.
- Ndjekja e zbatimit të detyrave të lëna nga zv. Rektori për anën mësimore për hedhjen e të dhënave në formatin e ri të Planeve mësimore.
- Përfundimi i Listë-Pagesës nr. 2 të personelit mësimor të ftuar.
- Kontrolli i Evidencave të punonjësve mësimorë të brendshëm; Përpilimi i Listë-Pagesës së mbinormës (30%) për vitin akademik 2012-2013, për të tre fakultetet: FAS, FAB, FM.
- Përgatitja e formatit të unifikuar të Vërtetimeve për studentët të shkarkueshme nga Faqja zyrtare e UART në internet për secilin prej tre fakulteteve, me specifikat përkatëse.
- Monitorimi i procedurës së aplikimit për Kartën Bashkiake të studentit, sipas Urdhrit të Rektorit.
- Verifikim pranë sekretarive e dokumentacionit zyrtar që lidhen me procesin mësimor dhe veprimtaritë e tjera të sekretarive: **Regjistrat** e Diplomave të Masterit (edhe MND e FM); **Lista** e notave që shoqëron Diplomat e Masterit; **numri** i studentëve pa nr. Matkulimi; **kontakte** të vazhdueshme me përgjegjësen e sektorit të informacionit për zgjidhjen e problemeve.
- Shpërndarja e Kuotave të Transferimit të studimeve nëpër fakultete.
- Ndjekja e procedurës së aplikimit të studentëve për përjashtim nga tarifa e shkollimit (**17 tetor - e vazhdim**).
- Verifikimi i dokumentacionit të plotësuar një vit më parë për Buxhetin 2012-2013; **analizë** e parashikimit të korrikut 2012 me Buxhetin e Dhjetorit 2012; **verifikim** sipas numrit të punonjësve mësimorë të brendshëm dhe të ftuar, sipas kategorive (*Prof/Prof.Dr; Prof.asoc; Dr; Docent; Lektor*); dhe orëve mësimore të realizuara prej tyre në dy ciklet e studimeve.
- Verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të studentëve aplikantë për Transferim studimesh në FAS; **monitorimi** i ligjshmërisë së procedurës së transferimit.
- Paraqitja zv. Rektorit për anën mësimore i Formatit të unifikuar të Pasqyrës së Notave, për Masterin, për çdo fakultet më vete (Sipas Udhëzimit të MASH-it Nr. 15, dt. 04.04.2008 „Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë“, Shtojca 2).
- Verifikimi i mbarëvajtjes së procesit të përpilimit të Syllabus-eve nga Njësitet bazë; **evidentimi** i problemeve.
- Kontakte me sekretaritet mësimore për ecurinë e plotësimit të Suplementit të Bachelor-it: **rakordimi** për përkthimin e pjesës në anglisht.
- Ndjekja pranë sekretarive e respektimit të afateve dhe detyrimeve të tjera ligjore për publikimin e listës së fituesve të ciklit të dytë Master; **përfundimi** i pajisjes me nr. Matkulimi (bachelor+master).
- Bashkëpunimi me Degën e investimeve të UART për implementimin e Projektit të ndërmarrë nga Dega e investimeve për mirëmenaxhimin e ambjenteve të UART; hedhja e të dhënave nga fakultetet në formularë të veçantë.
- Kontakte me përgjegjësit e njësive bazë të fakulteteve për dërgimin e Evidencave për të gjithë pedagogët e brendshëm.
- Nxjerrja e të dhënave për pedagogët e brendshëm që nuk kanë realizuar 30% mbi normë.
- Verifikimi i Orarit mësimor dhe Sallave/klasave të mësimit kolektiv për plotësimin e informacionit që kërkon sektori i investimeve.

- Kontakte me përgjegjësit e njësive bazë të fakulteteve për dërgimin e Evidencave të realizimit të orëve mësimore për vitin akademik 2012-2013 të pedagogëve të brendshëm dhe të ftuar që nuk i kanë dorëzuar ende (31 tetor – 15 nëntor 2013).

Nëntor 2013

- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e afateve dhe gjithë detyrimeve të tjera që lidhen me zbatimin e Udhëzimit të MAS nr. 54, dt. 29.10.2013 „Për procedurat e pranimit në raundin e dytë dhe regjistrimit të kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institutet publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2013-2014“.
- Trajnim për Modulën e Kërkimit shkencor në Universitetet dhe Institutet e Kërkimit – implementim i platformës SW „UGOV Albania“ nga konsorciumi italian CINECA dhe Qendra Ndëruniversitare e Shërbimeve dhe Rrjetit Telematik. 2-3.11.2013.
- Ndjekja bashkë me Përgjegjësin e IT të mbarëvajtjes së procesit të aplikimit të studentëve të UART me Kartën Bashkiake.
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e Urdhrit të MAS Nr. 466, dt. 05.11.2013, “Për shpërndarjen e kuotave për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në programin e studimit, të ciklit të dytë, ‘Master Profesional’, ‘Master i shkencave’, ‘Master i Arteve të Bukura’ me kohë të plotë [...], në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për vitin akademik 2013-2014”; ndjekja e shpërndarjes së kuotave sipas fakulteteve.
- Përpunimi dhe raportimi i të dhënave në MAS, sipas formatit IALP për veprimtarinë e personelit akademik të Universitetit të Arteve për vitin akademik 2012–2013: numri i stafit të brendshëm; numri i stafit të jashtëm; ngarkesa vjetore totale (në orë) e realizuar; norma vjetore (në orë).
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore të fakulteteve i respektimit të procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues në raundin e dytë në programet e studimit me kohë të plotë të UART për vitin akademik 2013-2014.
- Korrespondencë me sekretarinë mësimore të FAS për dorëzimin e dokumentacionit të dosjes së aplikantit për transferim studimesh, Benet Nelku; verifikimi i respektimit të procedurës ligjore të shqyrtimit të dosjes nga komisioni.
- Monitorimi i respektimit nga ana e sekretarive mësimore të afateve ligjore për zbardhjen dhe afishimin e listave të fituesve për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në UART për vitin akademik 2013-2014 faza e dytë.
- Ndjekja pranë sekretarisë mësimore të FAB të zbatimit të marrëveshjes ndërfakultetase për ndjekjen e kurseve të caktuara nga studentët e Uart; regjistrimi i studentëve të Masterit Shkencor të Muzikologjisë në lëndën Histori Arti në FAB.
- Hartimi i raportit institucional me të dhëna statistikore të kërkuara nga MAS; Hedhja e të dhënave për Pikat 3, 4 të shtojcës: Programet e studimit të UART me kohë të plotë - Bachelor, Master; Raporti student/pedagog i brendshëm, shkalla e kalueshmërisë gjatë vitit akademik 2012-2013 (e shprehur në %).;
- Përpunimi i të dhënave të planeve mësimore të FAS dhe FAB për vitin akademik 2013-2014; krahasimi me parashikimin e Buxhetit (realizuar në fund të qershorit 2013); Nxjerrja e të dhënave finale për Buxhetin 2014.
- Përfundimi i Listë-Pageës së mbinormës të pedagogëve të brendshëm;
- Ndjekja pranë sekretarive mësimore e zbatimit të Urdhrit Nr. 485, dt. 22.11.2013 të MAS “Për rishpërndarjen e kuotave të paplotësuara në programet e studimit, të ciklit të dytë, ‘Master profesional’, ‘Master i shkencave’, ‘Master i Arteve të Bukura’ me kohë të plotë, [...] në Institucionet publike të Arsimit të Lartë, në vitin akademik 2013-2014”.
- Ngritja e Grupit të kontrollit të brendshëm të ligjshmërisë sipas Urdhrit Nr. 96, dt. 27.11.2013, i Rektorit të Uart “Për ushtrimin e Kontrollit të brendshëm të ligjshmërisë në Fakultetet e Universitetit të Arteve”; E. Selita dhe E. Isak janë anëtare të grupit të kontrollit (në proces).

Dhjetor 2013

- Kontroll dokumentacioni dhe veprimtari sipas axhendës së miratuar nga Grupi i kontrollit të brendshëm të ligjshmërisë i ngritur sipas Urdhrit Nr. 96, dt. 27.11.2013, i Rektorit të Uart “Për ushtrimin e Kontrollit të brendshëm të ligjshmërisë në Fakultetet e Universitetit të Arteve” (**në proces**).
- Kontakte me shefat e departamenteve për freskimin e informacionit në Pasqyrën e ngarkesës mësimore të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar për vitin akademik 2013-2014, me të gjitha ndryshimet që janë bërë në lidhje me: emërtesën/pozicionin/gradën shkencore/titullin akademik.
- Plotësimi i formularëve për degën e Investimeve (**në proces**).
- Hartimi i Programit të Punës së Degës Mësimore dhe Zhvillimit të Kurikulave për vitin 2013 (**në proces**).
- Përpunimi i të dhënave të planeve mësimore të FM për vitin akademik 2013-2014; krahasimi me parashikimin e Buxhetit (realizuar në fund të qershorit 2013); Nxjerrja e të dhënave finale për Buxhetin 2014 (**në proces**).
- Ndjekja e procedurës së aplikimit të studentëve për përjashtim nga tarifa e shkollimit (**17 tetor - e vazhdim/ në proces**).

PJESA E DYTË

VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE



KREU I PARË**PROJEKTE DHE INVESTIME**

Dega e Investimeve e ushtron aktivitetin njevjecar mbi bazen e detyrave te pershkruara ne Planin e Punes te pregatitur ne muajin Janar i cili gjate rruges peson edhe permiresime te lidhuara me shtesa dhe te tjera ndryshime te domosdoshme. Kjo per faktin se shume detyra te lidhuara me aktivitetin e kesaj dege jane te ndervarura dhe te nderthurura me shkaqe objektive dhe subjektive.

Viti 2013 edhe pse nje vit *me buxhet teper te kufizuar per investime* ka qene i ngarkuar kryesisht me pune hulumtuese. Keshtu, jane bere perpjekje te vazhdueshme per te njohur me ne detaje problemet specifike qe ka Universiteti i Arteve. Kjo, edhe per arsyen e nje angazhimi qe kemi mare ne kuadrin e pregatijes te nje studimi per hartimin e Detyres se Projektimit dhe Termave te References, gje e cila eshte e lidhur ngushte me perspektiven dhe strategjine e institucionit. Perpjekjet per kurorizimin e kesaj sipermarjeje jane sa voluminoze, aq edhe te veshtira per arsyen e vetme te "specifikes" se institucionit.

Detyrat themelore te Deges se Investimeve jane:

- ✓ Inspektimi dhe kontrolli teknik i ndertesave dhe sherbimeve,
- ✓ Investigim i vazhdueshem i zhvillimeve ne UART,
- ✓ Hartimi i strategjise se investimeve per institucionin,
- ✓ Hartimi i planeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata nepermjet projekteve,
- ✓ Planifikimi i investimeve sipas prioriteteve dhe skemes teknologjike te funksionimit te institucionit,
- ✓ Pregatitja e Projekt-Buxhetit zeri investime,
- ✓ Menaxhimi i fondeve te investimeve dhe meremetimeve sipas nje plani te miratuar nga Rektorati dhe Keshilli i Administrimit;
- ✓ Realizimi i projekteve dhe investimeve ne parametra teknike me pjesemarjen e specialisteve te fushave perkatese dhe kontributin e akademikeve nga fusha e artit njekohesisht petagoge te UART por edhe me kontributin e stafit ndihmes te UART;
- ✓ Kompletimi ne vijimesi i kartotekes teknike te institucionit;

Prioritetet e Deges se Investimeve:

- ✓ Prioritet themelor eshte menaxhimi i fondeve me efektivitet,
- ✓ Prioritet baze eshte percaktimi i rradhes dhe shkalles se realizimit te investimeve i udhehequr nga projektet dhe vetem projektet,

Detyrat jane ushtruar gjate gjithë vitit ritmiksht duke ndjekur dhe zgjidhur cdo problem kurse prioritetet jane reflektuar ne pregatijen e *Projekt-Planit* te investimeve per periudhen 2014-15-16.

Me poshte po analizojmë treguesit kryesore:

Investime themelore gjate vitit 2013

A. Salla e Lektoriumit

Rikonstruksioni dhe rimodelimi arkitektonik dhe funksional i kesaj salle eshte planifikuar me dy projekte:

1. "Rikonstruksioni ndertimor dhe rimodelimi arkitektonik", investimi i kryer gjate vitit 2012 u certifikua me sukses pas nje periudhe garancie njevjecare;
2. U bene perpjekje te vazhdueshme per realizimin e projektin me objekt: **"Kompletimi me pasije audio-vidio dhe profesionale"** ne sherbim te procesit mesimor. Ky projekt u riformulua edhe ne kushtet e nje fondi te reduktuar, por nuk u mundesua prokurimi i tij. Keshtu, vazhdimesia e tij mbetet prioritet per te ardhmen.

B. Projekti per ndertesën e Korpusit Kryesor

Eshte pregatitur dhe miratuar Detyra e Projektimit te objektit. *Ka perfunduar faza e pare e projektit ku perfshihet:*

- riformulimi ne parametra bashkekohore i infrastruktures inxhinjerike ne te gjithë treguesist e saj,
- punime ndertimi shoqeruese te punimeve infrastrukture,
- ndertimi i nje depozite qendrore uji me kapacitet 200 m³,

Eshte ne proces pregatitja e projektit te plote ndertimor dhe ai i arkitektures, siper marrje e iniciuar nga "Dea Studio". Jane bere disa takime dhe konsulenca me studion e mesiperme mbi Detyren e Projektimit dhe jane saktësuar detajet e projektit. Jemi ne pritje te hollesirave rreth projektit.

C. Studimi dhe Hartimi i Detyres se Projektimit.

Studimi dhe Hartimi i Detyres se Projektimit, si procesi me i rendesishem per mbeshtetjen ne ndertimin e se ardhmes se institucionit, ka qene detyra me prioritare gjate vitit 2013 ne fushen e Investimeve. Theksojme se 'procesi per realizimin e ketij studimi eshte kompleks, politeknik, i shtrire ne kohe dhe me te panjohura kryesisht persa i perket perceptimit te procesit mesimor dhe standartizimit te hapësirave dhe infrastruktures mbeshtetese'.

Dokumenti i studimit eshte i strukturuar ne pese kapituj:

- a. pershkrimi i situates urbanistike&arkitektonike dhe sherbimet,
- b. skema funksionale e institucionit,
- c. procesi mesimor (struktura,organizimi,menaxhimi i ambienteve,kompletimi me paisje dhe sherbimet baze),
- d. analiza e problemit,konkluzione dhe konsiderata ekonomike,
- e. temat e references dhe rekomandime

Nuk jane realizuar afatet sipas parashikimit, por procesi eshte aq kompleks dhe voluminoz, sa mund te krahasohet me objekte te ngjashme te rendesise se vecante te cilat jane realizuar deri me sot ne vendin tone.

Nga ana tjetër theksojmë se shkalla e seriozitetit dhe përgjegjshmërisë nga ana e jone synon aq e lart sa nuk duam të anashkalojmë asnjë detaj të fazës studimore duke respektuar çdo element të saj dhe mbi të gjitha legjislativën. Aktualisht, janë përfunduar etapën sipas pikave **a, b, e** dhe janë në proces etapën **c & d**. Koha e përfundimit të dokumentit do të shtrihet edhe gjatë vitit 2014 dhe **nje date përfundimtare është e lidhur edhe me angazhimin e strukturave të tjera të institucionit**. Ky dokument është objekt i një diskutimi në shkallë të gjërë dhe *angazhimi për ta përfunduar është faktori kryesor*.

Ka arritur në përfundime paraprake studimi mbi treguesit e matshëm që ndikojnë në mesimdhënie në Fakultetin e Arteve të Bukura dhe përmbyllet me një numër këshillash drejtuar trupës vendimmarrëse, këshilla të cilat mendojnë se parashtrajnë mënyra zgjidhjeje për problemet e hasura gjatë procesit të mesimdhënies. Këto këshilla gjithashtu, shërbejnë edhe si një udhërrëfyes për zhvillimin e ardhshëm të Fakultetit të Arteve të Bukura, duke përqendruar vëmendjen në krijimin e hapësirave të nevojshme dhe të mjaftueshme për kryerjen e një vijueshmërie të mesimdhënies me dobishmëri të lartë dhe të vlefshme për studentin.

Studimi analizon një *periudhë akademike gjashtëvjeçare (2007-2013)* dhe përfshin në të "mobilimin" dhe pajimin "tip" të ambienteve të mesimdhënies. Thellimi i studimit deri në kostot aktuale dhe kostot hipotetike të veprimtarisë në fakultet është një risi që do të shërbejë në projektimin e sigurt të së ardhmes për vet institucionin.

Metodologjia e ndjekur për kryerjen e studimit ka përfshirë:

- ✓ Leximin, studimin dhe analizimin e dokumentacionit mbi bazën e të cilit zhvillon veprimtarinë mësimore e administrative ky Fakultet;
- ✓ Kryerjen e intervistave me anëtarë të grupit të mesimdhënësve dhe studenteve edhe nepermjet pyetesoreve të përgatitura për çdo specialitet;
- ✓ Vizitat e kryera në mjediset e Fakultetit, të cilat shërbejnë për zhvillimin e veprimtarive formuese apo veprimtarive të tjera, të parashikuara në programet e studimit;
- ✓ Analize të detajuara të marrëdhënieve midis treguesve të matshëm të "Didaktikës Mesimore",
- ✓ Të dhëna në shifra rreth numrit të studenteve dhe dinamika e zhvillimit,
- ✓ Të dhëna statistikore rreth marrëdhënieve student&mesimdhënes,
- ✓ Të dhëna statistikore rreth marrëdhënieve student&mjedis universitar,
- ✓ Të dhëna rreth "dokumenave baze",
- ✓ Përgatitje raportit paraprak,

Dokumenti studimor '*faza paraprake*' është realizuar në masën **80%** dhe i është drejtuar dekanit të fakultetit njëkohësisht kryetari i Grupit të Punes z. Artan Peqini për diskutim, analizim, plotësim dhe përgatitjen e rekomandimeve përkatëse.

Deri në përfundimin e plotë materialit studimor do të kalojë edhe në këtë etapë:

- ✓ Takim dialogues me grupin e punës dhe grupet e interesit,
- ✓ Konkluzione,
- ✓ Thellimi i studimit për plotësimin me analiza të detajuara të kostove dhe informacione të tjera të rëndësishme,

- ✓ Nxjerja e rezultatit perfundimtar dhe paraqitja tek organet drejtuese dhe Grupi i Punes per vendimarrje.

Konkluzionet e ketij materiali do te jene pjese e rendesishme e ***Detyres se Projektimit***.

Dokumenti studimor i pregatitur ka kete permbajtje:

- Hyrje (1 faqe)
- Struktura e studimit (1 faqe)
- Studimi mbi hapesirat fizike referuar Programit Mesimor (25 faqe)
- Studimi per treguesit e matshem (86 faqe)
- Studimi per Fondin&Galerine e FAB-it (9 faqe)

Njekohesisht eshte perfunduar i plote pjesa takuese e studimit per:

- Rjetin e IT , (13 faqe)
- Biblioteka, (18 faqe)
- Salla e Lektoriumit, (7 faqe)
- Salla B-Box, (6 faqe)

Perfundimi i plote i studimit kerkon nje ***angazhim te gjere ne nje kohe te kufizuar*** ne menyre qe te plotesohen objektivat dhe afatet. Per kete eshte e domosdoshme nje plan-pune i posacem me emra dhe afate konkrete.

D. Pregatitja e Projekt-Planit te Investimeve dhe Projekt-Buxhetit

Keta dy elemente jane bashkeudhetare, plotesojne dhe kombinojne njeri tjetrin. Nga analiza e deritanishme e investimeve te realizuara dhe projekteve ne proces rezulton se ***per cdo investim shtese ne ndertime dhe infrastruktura, linden kosto shtese te sherbimeve dhe per rrjedhoje edhe te shpenzimeve te cilat na inicjojne per nje analize te thelluar ekonomike dhe rrjedhimisht edhe per praktika te reja pune.***

Keshtu, eshte domosdoshmeri organizimi i punes *per pregatitjen e nje studimi tekniko ekonomik* i cili do te shoqeroje studimin baze dhe do te thelloje analizen e shpenzimeve, shoqeruar me koston perkatese ne menyre qe "projektuesi" dhe investitori te jete i mireorientuar.

Eshte mire qe kjo analize ti referohet nje periudhe 5-vjecare dhe prej saj te perftohen koston e realizuara deri me sot per cdo sektor apo sherbim dhe mbi keto te dhena te planifikohet riformulimi i praktikave aktuale. E thene ndryshe te llogariten ***koston aktuale dhe koston hipotetike.***

P.sh. n.q.s. sot ka nje shkalle perdorimi te rrjetit LAN ne 25 % te nevojave dhe shpenzojme X lek, ne te ardhmen me investimet ne rritje do te kemi nje kosto tjeter te ketij sherbimi, ose n.q.s. sot mbulohen me sistemin e ngrohje – ftohje-ventilimit 60% e ambienteve dhe koha e perftimit te ketij sherbimi eshte e reduktuar, ne te ardhmen me investimet ne rritje do te kemi nje tjeter kosto, e keshtu me rradhe per cdo sherbim. Dhe kjo behet e mundur

kur funksionojne te gjitha hallkat ne forme zinxhir dhe cdo sektor dhe dege ka te evidentuar cdo shpenzim apo sherbim.

Keshtu:

Dega e Sherbimeve, Dega e Investimeve dhe administratoret e fakulteteve duhet te kene te regjistruara ne kartoteken e tyre edhe dokumentacionin perkates per meremetime, riparime apo rikonstruksione. Permendim ketu nga ato te realizuara ne vitet e fundit si "meremetimi i taraces se skenografise", "meremetimi i ambienteve te godines B", "meremetimi i fasadave", "meremetimi i tualeteve salla B-Box", "meremetime ne rjetin e ngrohjes", "instalimi i sistemit te aspirimit kati perdhe fakultetit te Arteve Bukura", "riparime te sistemeve te kondicionimit" etj., veprime financiare te lidhura me sasine, vleren, cilesine, garancine etj., te dhena qe duhen per ndertimin e nje pune te studiuar dhe te parashikuar drejt.

Pra "**standarti**" qe po projektojme sot perfaqeson ne vetvete nje **kosto investimi** dhe **me pas nje kosto sherbimi**. **Keto analiza shkojne paralel dhe kombinohen me njera tjetren gjate rruges**. Por, keto analiza jane te lidhura ngushte apo jane produkt i financimit i cili ka dy burime:

- Buxheti i Shtetit,
- Te Ardhurat.

Raporti midis ketyre dy treguesve mund te ndryshoje dhe situata mund te tronditet dhe nje **plan-rezerve** per rritjen e te ardhurave dhe uljen e shpenzimeve do te ishte i mirepritur. Ky **plan** nuk mund te pregatitet pa evidenca te sakta dhe rezultatet konkrete. **Dhe keto evidenca dhe rezultate nuk mund te plotesohen pa nje praktike tere zinxhir midis te gjitha strukturave te prapavijes se institucionit.**

E. Rikonstruksione dhe meremetime te realizuara gjate vitit 2013

Gjate vitit 2013 eshte realizuar nje objekt investimi me prokurim:

"*Rikonstruksioni i taraces se Godines B*".

- u pregatit dokumentacioni teknik,
- u realizua procedura e prokurimit,
- u ndoqen punimet me perparesi deri ne perfundimin e objektit,
- u plotesua dokumentacioni teknik dhe ligjor perkates,
- vazhdon veshgimi per ecurine e investimit,

Por eshte realizuar edhe nje investim nga institucioni me burimet e veta me objekt: "Adaptimi dhe rikonstruksioni i ambienteve te reja te mesimdhenies" me destinacion per degen e Skenografise dhe degen Regji Filmi dhe TV.

Kjo sipermarje eshte per tu vleresuar ne vecanti per sektorin e sherbimeve. Per arsye te nje bashkepunimi profesional midis dy degeve Investime dhe Sherbime pjese te punimeve kryesore po i paraqesim ne kete material:

Ky investim eshte realizuar nga burimet e vet institucionit (fuqi puntore dhe baze materiale) nen drejtimin e Deges se Sherbimeve dhe Deges se Investimeve ne bashkepunim me anen ekonomike te rektoratit, pa anashkaluar kontributin e zv.rektorit per anen mesimore.

Eshte kryer nje volum i konsiderushem pune si:

- punime cmontimi, prishje dhe largim mbeturina, rreth 3500 ore pune,
- punime ndertimore ambientet e skenografise, rreth 1000 ore pune,
- punime ndertimi ambientet e regji&filimit, rreth 1500 ore pune,

Gjithsej rreth **6000 ore pune** nga specialistet e sektorit te sherbimeve. Paralelisht Dega e Sherbimeve ka perballuar te gjitha punimet e tjera te riparimeve emergjente dhe mirembajtjes periodike si:

- eliminimi i difekteve hidraulike dhe lageshtive ne nyjet sanitare te nderteses B, (fakulteti i Muzikes),
- eliminimi i difekteve ne nyjet sanitare te nderteses A, (fakulteti i Muzikes),
- mirembajtje e riparime te ndryshme ne rrjetin hidraulik, elektrik etj.,
- jane bere riparime ndertimore, lysterje etj.,
- gadishmeri e pote e ambienteve per mesimdhenie,

N.q.s. i shprehim ne volume edhe punimet e tjera rezulton se punonjesit e sektorit te sherbimeve e kane justifikuar kohen e punes plotesisht. Por vazhdimesia e kesaj pune eshte e lidhur kryesisht me dy faktore te rendesishem:

- kualifikimi profesional i vazhdueshem i punonjesve,
- planifikimi korekt i furnizimit me materiale,

Nga ana tjetere, theksojme se me gjithe punen sa cilesore aq dhe voluminoze te vitit 2013 ne objektet e mesiperme *ka volume pune te paperfunduara per mungese baze materiale. Keshtu:*

- nuk jane perfunduar riparime ndertimore ne nyjet sanitare te godinave A & B, ku perfshihet vendosje tavani k.xhes, veshje me pllaka, etj.,
- nuk jane bere punimet elektrike ne ambientet e ish studio xhesit, etj.

F. Te tjera operative te realizuara gjate vitit 2013

- ndjekje e vazhdueshme e problemeve ne proces,
- pregatitje e dokumentacionit të brendshem dhe komunikimi me deget e sektoret,
- pregatitje e dokumentacionit të jashtem,
- ndjekja e puneve operative,
- formulimi i te gjitha dokumenteve te tjera zyrtare,

KREU I DYTË**BURIMET NJERËZORE**

Kryetari i Degës së Burimeve Njerëzore, duke qenë Autoriteti Përgjegjës në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë për UART (Miratuar nga ILDKP 2003), në zbatim të Ligjit Nr, 9367, datë 07/04/2005 "Për parandalimin dhe Konfliktin e Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore të ILDKP-së, në fund të muajit Janar 2013, informoi në këtë Inspektoriat për rastet e konfliktit të interesit, rast pas rasti, për vitin paraardhës. Duke filluar nga muaji Shkurt – Prill 2013, përgatiti dokumentacionin për subjektet që deklarojnë pasurinë në këtë Inspektoriat, duke konsultuar dhe ndihmuar subjektet për paqartësitë ndaj këtij deklarimi. Gjithashtu kontrollon konfliktin e interesave në administratën dhe Fakultetet e UART sipas akteve ligjore në fuqi. Po ashtu ka njoftuar ILDKP, periodikisht sipas kërkesave të tyre, rreth konfliktit të interesave të autoriteteve, në Universitetin e Arteve.

DBNJ gjate 2013 ka treguar kujdes ne vazhdimesi per organizimin dhe përpunimin e Strukturës Organizative dhe Analitike të UART, duke u konsultuar me Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e Njësive Kryesore për përputhshmërinë sa më konkrete të pozicioneve të punës me kualifikimin përkatës të çdo punonjësi mësues, duke u konsultuar me VKM 331 me dryshimet përcatëse sipas kërkesave të sektorëve, të Fakulteteve.

Në muajin Gusht 2013, u përgatit ndryshimi i pagave për punonjësit e administratës së UART, sipas legjislacionit përkatës.

Në bashkëpunim me Zv/Rektorin Mësues dhe Njësitë Bazë të fakulteteve kjo dege ka përgatitur procedurat e konkursit për marrjen në punë të punonjësve mësues të ftuar. Ky proces fillon me nxjerrjen e kërkesave të Fakulteteve në Faqen e Web-it të UART në muajin Gusht 2013 dhe përfundon ne fillim të procesit mësues. DBNJ për çdo hap të procesit të rekrutimit të punonjësve mësues të ftuar, informoi Rektorin për mbarëvajtjen e procedurave dhe zbatimin e Urdhërave nga Komisionet ad-hoc te Fakulteteve, deri në përfundimin e tyre duke e finalizuar me miratimin e punonjësve nga Rektori.

Kjo degë në bashkëpunimin të vazhdueshëm me Degën Juridike, përgatiti materialin e Miratimit të PMF, Projekt – Vendimin duke ia paraqitur Senatit Akademik për miratimin e punonjësve në përshtatshmëri me aktet ligjore në fuqi. Në vijim të kësaj sekretariati teknik përgatiti dhe materialin për miratimin e numrit të punonjësve të ftuar në Këshillin e

Administrimit të UART. Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, të Kodit të Punës, Kodit të procedurave Administrative, kjo Degë ka ndjekur procedurat e marjes në punë të punonjësve të administratës dhe personelit mësimor në tre fakultetet në muajt Korrik – Nëntor 2013. Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit të UART dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, kjo Degë, ka ndjekur me perparësi procedurat e kualifikimeve të punonjësve dhe sistemimin e tyre në pozicionin e punës sipas kualifikimit përkatës.

Fakultetet	Prof	Prof.Asoc	Doktor	Doc.	Lektor	gjithsej
1. Muzikë	9	6		1	6	22
	11	19		5	13	48
2. Arti Skenik	9	5		1	3	18
	5	10	1	3	5	24
3. Artet e Bukura	1	3			2	6
	5	5		1	6	17
Gjithsej	40	48	1	11	35	135
STAFI AKADEMIK EFEKTIV që ka marre titull 2012 e vazhdim						
Fakultetet	Prof	Prof.Ass	Doc.Dr	Doc.Ma		gjithsej
1. Muzikë	3	1		2		6
2. Arti Skenik	7	7				14
3. Artet e Bukura		5		1		6
gjithsej	10	13	0	3		26

Në bashkëpunim me Kancelaren dhe Degët respektive që merren me Buxhetin e UART, u përgatit dhe materiali për Buxhetin 2014.

Sektori i Arkivës

Duke qene se Universiteti i Arteve eshte i vetmi institucion i llojit te vet ne Shqipëri, shtrohet edhe më shumë nevoja e inkuadrimit të arkivit në rrjedhat bashkëkohore të arkivistikës, duke u përfshirë në të gjitha mekanizmat ndërkombëtare të menaxhimit zyrtar, informimit etj.

Si rrjedhoje e kësaj nevojë dhe gjendjes së dokumentacionit që ndodhet pranë këtij institucioni jemi duke përpunuar projektin për krijimin e Arkives Dixhitale Administrative për Rektoratit të UART. Që të arrihet deri në atë fazë Arkivi i UART-it ka disa etapa të tjera neper të cilat duhet të kalojë ky dokumentacion.

Duke pare gjendjen e dokumentacionit ka qene i domosdoshem hartimi i nje plani pune i cili eshte miratuar nga Rektori i UART dhe konsiston ne sistemimin e gjithë pasurise fizike te ndodhur prane ketije institucioni.

Nga data 22.04.2013 deri me 26.04.2013, prane zyres se Arkivit eshte bere hapja e tre kutive me dosje, konkretisht e kutive qe mbi kapakun e tyre mbajne vitet: 1973, 1979 dhe 1980.

Mbas verifikimit rezultoi se brenda këtyre kutive ekzistonin dokumente te disa viteve duke filluar nga viti 1974 e deri ne vitin 1994.

Nisur nga kjo gjendje faktike doli e nevojshme të hartohet programi i punës dhe të realizohet sistemimi i dokumentacionit qe ndodhet pranë kësaj zyre.

Ky plan pune do te perqendrohej ne ; Klasifikimin sipas viteve, Klasifikimin sipas struktures, dhe klasifikimin sipas njesise se ruajtjes.

Nga koha qe eshte hartuar plani i punes e deri në fund të vitit 2013 ende punohet me piken e pare te planit. Kjo procedure do shtrihet përtej afatit te paracaktuar ne plan per arsye se dokumentacioni eshte ne nje gjendje shume te papërshtatshme fizike.

Sektori IT

Ne funksion te proceseve te IT, gjate vitit 2013 janë realizuar:

- Hartimi i specifikimeve hardware per investime sa me efikase ne infrastrukture;
- Trainimi ne perdorim dhe suportin e vazhdueshem per personelin qe e shfrytezon sistemin e Arkives Dixhitale tek biblioteka – si dhe nderhyrjet ne kodin e programit ne funksion te permiresimit te sistemit (te drejten mbi kodin e te cilit e rezervoj vete si nje projekt dhe investim personal profesional/intelektual);
- Studimet per shfrytezimin e teknologjise se informacionit ne Institucion dhe parashtrimet per investime te reja me dosjet e dorezuara ne Degen e Investimeve kohe pas kohe te vertetueshme nepermjet arkives eMail Institucionale;
- Mire-menaxhimi i bashkepunimeve me projekte te ndryshme sic jane projekti i Rrjetit Akademik Shqiptar, Postes Shqiptare, dhe Bashkise se Tiranës, me shkembim informacioni dhe studimesh, ure lidhese komunikimi me personelin administrativ ketu, menaxhim i zbatimit te projektit te Postes Shqiptare qofte nga pikepamja logjistike dhe infrastrukture, qofte nga pikepamja dokumentacionit dhe komunikimit, menaxhim i zbatimit te projektit te Bashkise Tirane per pajisjen e studenteve me karten bashkiake qofte nga pikepamja logjistike dhe infrastrukture, qofte nga pikepamja e te kryerit te operatorit per keto aplikime;

- Administrimi i faqes web te institucionit me materialet e hedhura ku angazhim kryesor ka qene hedhja e eventeve multimediale, dhe nderhyrjet e kryera kohe pas kohe ne kodin e faqes ne kontakt te ngushte me dizenjuesin e saj i cili rezervon te drejten mbi kete kod;
- Skanime dokumentacioni shkresor administrativ per ta pasqyruar ate ne web;
- Monitorimi i vazhduar edhe ne distance te mbarevajtjes se rrjetit kompjuterik Wired & Wireless te institucionit ne orarin 8 te mengjesit deri ne 10 te mbremjes per 7 dite te javes (ku shpesh here me eshte dashur te zgjidh situata problematike gjate pasditeve ne mbeshtetje te zhvillimit te aktiviteteve te ndryshme ne UART);
- Pjesemarrjen me atributet e perfaqesuesit IT te Institucionit ne shume workshop-e dhe seminare ne funksion te zhvillimeve te IT ne rrafsh universitar , publik dhe qeveritar, si dhe raportimin tek eproret.
- Konfigurimi ne origjine, mirembajtjen e vazhdueshme te cdo njesie kompjuterike te institucionit duke riparuar defekte, instaluar apo mirembajtur programe, sisteme antivirus, konfigurim per shkembim materialesh P2P ne rrjet per administraten, etj, dhe konkretisht:
 - o Institucioni ka ne total 40 kompjutera per personelin administrativ te ndare ne Rektorat dhe Fakultete te cilet kerkojne vazhdimisht gatishmeri maksimale;
 - o + 37 njesi kompjuterike ne laboratore te ndryshem dhe me specifika te ndryshme te proceseve te punes (biblioteka, laboratoret e filmit, laborator i elektroakustikes ne fm, laborator i multimedias ne fab);
 - o + 7 servera institucionale (3x te bibliotekes, 1x fileserver administrativ, 1x serveri i sekretarise mesimore, 2x network attached storage);
 - o Mbi 18 pajisje kompjuterike te nderlidhjes se rrjetit kompjuterik te berbere nga 7x+ switch-e, 1x media converter per fibren optike, 2x media transmission per fibren optike, routeri/firewall qendror i institucionit, 2x routera seksionale, 2x antena hotspot wireless, 4x antena wireless te brendeshme te lokalizuara ne ambiente te ndryshme, etj;
 - o Konfigurim ne pajisje printer rrjeti aktualisht 5 cope, si dhe printera te panumert individuale neper zyra nje pjese e te cilave shfrytezohen edhe keta ne rrjet nepermjet zyrave;
 - o Pa lene menjane njesi kompjuterike personale laptop apo desktop te stafit administrativ dhe trupes pedagogjike te cilet kerkojne konfigurim per akses ne internet dhe rrjet ne funksion te proceseve akademike dhe te mesimdhenes.

Duhet te nenvizohet fakti se nje asistence çfarëdo ne procese kompjuterike per administratën apo pedagoge te UART zgjat mesatarisht nga 10 – 40 min, kohe kjo e dedikuar ne funksion te suportit per zgjidhjen e problemit.

KREU I TRETË

MARRËDHËNIET ME JASHTË

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë është një hallkë e rëndësishme në Universitetin e Arteve. Ajo mbështet Universitetin e Arteve në realizimin e misionit të përgjithshëm duke promovuar dhe angazhuar në nivel ndërkombëtar me programet e zhvillimit akademik dhe kulturor. Dega e Marrëdhënieve me Jashtë bashkëpunon me njësitë e tjera brenda UART dhe partnerët e jashtëm në krijimin, zbatimin dhe koordinimin e projekteve/ programeve akademike dhe kulturore për të nxitur dhe zhvilluar në ecurinë e punës mësimdhënëse, studimore, artistike të universitetit si dhe në punën kërkimore-shkencore në fushat e artit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- I. Angazhimet akademike dhe kulturore të UART brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë
- II. Zhvillon fokusin ndaj partnerëve strategjikë në rritjen e angazhimeve ndërkombëtare
- III. Promovon punën akademike dhe artistike të UART dhe shpërndan nëpër Fakultetet e UART informacionin mbi aktivitete akademike, kërkimore, kulturore në sferën globale për personelin akademik dhe studentët
- IV. Ndjek pjesëmarrjen e UART në Organizatat Ndërkombëtare dhe Shkollave të Artit në Botë

Arritjet Kryesore:

- I. **Angazhimet akademike dhe kulturore të UART brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë**

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë ka punuar ngushtë me secilin nga fakultetet e universitetit gjatë gjithë vitit 2013, për të ofruar mbështetje, informacione dhe kontakte për rritjen e angazhimit me institucione ndërkombëtare. Nën kujdesin e kësaj dege të tre fakultetet janë angazhuar në projekte të rëndësishme akademike dhe artistike me partnerë ndërkombëtarë.

Nr.	Titulli i aktivitetit/projektit	Datat 2013	Institucioni (et) partner me UART	Pjesëmarrës nga UART	Komente mbi aktivitetin
1	Seminari i hapur i baletit gjithëpërfshirës	25 Mars	Këshilli Britanik	FAS, Kursi i Koreografisë	Në bashkëpunim me Këshillin Britanik, u mundësoi sjellja e kompanisë së Kërcimit Candoco. Kjo kompani e kërcimtarëve me dhe pa aftësi të kufizuara e përfaqësuar nga tre balerinë të saj, zhvilloi seminarin mbi baletin gjithëpërfshirës me kombinim të teknikave bashkëkohore të kërcimit dhe qëllimin krijues koreografik, duke i ftuar pjesëmarrësit për të shqyrtuar idetë dhe të udhëhiqen për të krijuar lëvizjen e tyre.
2	Ekspozitë e studentëve "Treni" & "Tirana 24 orë"	15 – 17 Mars	Ambasada Franceze	FAB	Kjo ekspozitë ishte produkt i një trajnimi dyjavor të organizuar në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Tiranë të drejtuar nga pedagogu fotograf francez Arnaud Brunet dhe pedagogu i fotografisë në FAB Albes Fusha.
3	"Ura me Tri Harqe"	20 - 21 Maj	Fakulteti i Arteve, Universiteti Prishtinës, Fakulteti i Arteve, Universiteti Tetovës	FM, FAS, FAB	Universiteti i Arteve në Tiranë ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në këtë edicion jo vetëm si institucioni pritës duke vënë në dispozicion ambientet tij, por dhe në organizimin dhe angazhimin e pedagogëve dhe studentëve në ngritjen e një programi sa më profesional të drejtuar nga Rektori i Universitetit të Arteve Prof. Petrit Malaj. Gjatë këtyre dy ditëve aktivitetet kanë qenë të shumta si: ekspozitë e përbashkët në Galerinë FAB; Shfaqje teatrale; projeksione filmash të shkurtër; koncert festiv i përbashkët.
4	Konkursi Ndërkombëtar për skulpturën EDGARDO MANNUCCI, Arcevia, Itali	25 Maj		FAB	tre studentë të Skulpturës në Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve: Bledian Ibrahimllari, Polikseni Hasani dhe Elton Vaska të shoqëruar nga pedagogu i Skulpturës Monumentale Arben Bajo,- përfaqësuan denjësisht Universitetin tonë, në edicioni i XX të "Çmimit Ndërkombëtar për skulpturën EDGARDO

					MANNUCCI" në Arcevia, Itali. Ky konkurs ndërkombëtar i përvitshëm, është shumë i rëndësishëm për artistët e rinj të Akademive dhe Shkollave të Larta të Artit në Itali dhe në Botë, ku krahas lidhjeve që krijohen mes institucioneve bëhet dhe promovimi i artistëve të rinj. Në këtë konkurs studenti Bledian Ibrahimllari mori çmimin e parë me veprën e tij në allçi TORS.
5	Bisedë me Skenaristin David Foenkinos	25 Maj	Ambasada Franceze	FAS	Me prezencën e skenaristit të filmit z. David Foenkinos u shfaq Filmi i tij i fundit "La Délicatesse" për studentët e degës së filmit në Sallën Black Box të Universitetit të Arteve. Në këtë bashkëbisedim shkrintari shpjegoi vështirësitë e adaptimit të romanit të tij me të njëjtin titull në skenar filmi, si dhe pikat kryesore ku duhet të fokusohen studentët kur shkruajnë një skenar.
6	ANIMART 2013	14 -21 Korrik	Shkolla ANIMART	pedagogu Ilir Kaso dhe 7 studentë nga FAB dhe FAS	Këtë vit ky aktivitet i përvitshëm ndërkombëtar u mbajt në Monodendri, Janinë, Greqi. ANIMART do të thotë një kurs veror për studentët dhe artistët e rinj që kanë interes për të pasuruar njohuritë e tyre mbi mediat digjitale, animacion, kinema etj dhe të kalojnë një javë të plotë mes artit dhe aktiviteteve të tjera me kolegë të tyre nga shtete të tjera.
7	Master Klasa në Piano	4 – 5 Nëntor	Universiteti Agder, Norvegji	FM, Kursi i pedagoges Merita Tërshana	Master Klasa në piano me profesorin Norvegjez, Prof. Asoc. Tellef Juva u organizua në kuadër të bashkëpunimit të vendosur mes UART dhe Universitetin Agder në Norvegji.
8	Seminar dhe përgatitje për shkrim skenari <i>(Pas një pune përgatitore dhe një bashkëpunimi të vazhdueshëm me Ambasadën Franceze</i>	1 Maj – 30 Qershor <i>(Faza e parë)</i>	Ambasada Franceze	FAS, studentë të regjisë së filmit (v.3 B – v.1 -2 M)	Përgatitja e 12 skenarëve nga studentët e FAS. Në bashkëpunim me Elis Mataj dhe me Prof. Gazmend Gjoka u mblodhën skenarët nga Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe iu dërguan Ambasadës Franceze për t'u përkthyer në Frëngjisht dhe për t'iu dërguar profesorit francez Guy Mousset në Francë për t'i kontrolluar dhe komentuar.

9	<i>në Tiranë, në Prill 2013 filloi organizimi i një projekti afat-gjatë me degën e Regjisë së Filmit në Fakultetin e Artit Skenik, i cili u nda në 3 faza, ku dy prej të cilave janë zhvilluar në 2013 dhe e treta do të vazhdojë në 2014.)</i>	11 - 15 Nëntor (Faza e dytë)			U zhvillua seminari me profesorin Guy Mousset së bashku me 12 studentët e Regjisë së Filmit dhe audiencë të studentëve dhe profesorëve të FAS ku u punua mbi skenarët e dërguar paraprakisht në fazën e parë të projektit. Ky seminar pati përkrahje dhe sukses nga studentët dhe pedagogët pasi u punua mbi punë konkrete të studentëve dhe u dhanë sugjerime dhe komente mbi punën e tyre për ta përmirësuar atë.
10	Seminar me Producentin izraelit Z. Katriel Schory	31 Tetor	Ambasada e Izraelit	Studentët të FAS dhe të Multimedias (FAB)	Seminar mbi realizimin e një filmi dhe roli i producentit në të. Shembuj konkret nga shesh-xhirime dhe filma.
11	Workshop "Henry Moore - printmaker Nga letra në ajër"	11 Nëntor	Këshilli Britanik	FAB, studentët të specialitetit grafikë nën kujdesin e pedagogut Ardian Isufi	Një seminar tre dimensional vizatimi udhëhequr nga artistja Britanike, Sarah Gillett. Ky seminar ishte një mundësi për studentët për të shqyrtuar punët më të mëdha magjepsëse të Moore - marrëdhëniet ndërmjet artistit, figura dhe peizazhit. Qasja workshopit ishte që studentët të ishin të hapur për mënyra të reja të punës, ndarjen e ideve për zhvillime reflektuese. Duke punuar mbi Koleksionin e Këshillit Britanik, ekspozita Henry Moore - printmaker, studentët bënë një seri të monoprint dhe vizatime në fletë transparente të plastikës, të frymëzuar nga puna e Moore dhe aktivizimin e hapësirës.
12	Shfaqja e Dokumentarit mbi Henry Moore	4 Dhjetor	Këshilli Britanik	Studentët të Grafikës dhe Skulpturës, FAB	Henry Moore, një artist me famë botërore, ishte me interes që të prezantohej te të gjithë studentët e grafikës dhe skulpturës, për të mësuar dhe për të parë punën e tij të plotë. Ky dokumentar u prit me interes jo vetëm nga studentët por dhe pedagogët e lëndës.

13	Workshop me studentë të Kompozicionit	22 - 24 Nëntor	Ambasada Hungareze dhe Akademia Liszt, Budapest	4 studentë të degës kompozicion të shoqëruar nga Pedagogu Nestor Kraja FM	<p>Ky workshop erdhi pas një pune të gjatë dhe bashkëpunimi me Ambasadën Hungareze, e cila mundësoi dhe lidhjen me Akademinë prestigjioze të muzikës Liszt në Budapest.</p> <p>Ky workshop u drejtua nga profesori hungarez Horváth Balázs, dhe me pjesëmarrje të muzikantëve nga vendet e Platformës Kulturore të Evropës Qendrore, që ndodheshin në Shqipëri për një aktivitet tjetër të tyre. Muzikantët e huaj luajtën muzikën e kompozuar nga studentët dhe profesori Balázs jepte komentet dhe së bashku me studentët bënë rregullimet e nevojshme.</p>
----	---------------------------------------	----------------	---	--	---

II. Zhvillon fokusin ndaj partnerëve strategjikë në rritjen e angazhimeve ndërkombëtare

a. *Diplomacia e Universitetit – Delegacione & Koordinime*

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë është e angazhuar për të zhvilluar partneritete efektive me institucionet jashtë shtetit për të promovuar shkëmbimin akademik dhe bashkëpunimin kërkimor. Në përmbushje të këtij angazhimi janë organizuar takime me përfaqësi diplomatike të huaja në Shqipëri, me institucione partnere si dhe personalitete të tjera të artit.

Gjatë vitit 2013 janë organizuar takime zyrtare me 6 përfaqësues diplomatikë të vendeve nga të cilat është arritur të sigurohen: kontakte me Shkolla të Arsimit të Lartë dhe institucione të Artit në vendet e tyre, nga të cilat janë firmosur 2 marrëveshje bashkëpunimi në Serbi dhe në Hungari dhe janë në proces për t'u nënshkruar marrëveshjet me 2 Shkolla të tjera në Francë dhe në Itali. Gjithashtu nga këto takime janë arritur të organizohen 7 trajnime për studentë dhe pedagogë të UART.

Gjithashtu janë arritur të zhvillohen takime me organizata të huaja në Shqipëri dhe jashtë vendit, me qëllimin e realizimeve të projekteve të përbashkëta kulturore-artistike si dhe të mundësimit të zhvillimit të kurrikulës dhe gjithashtu dhe të përmirësimit të ambienteve të UART.

- i. Në Janar 2013 u vendosën kontaktet me Prof. Dr. Davut AYDIN, rektor i Universitetit Anadolu, Turqi. Në kuadër të një turneu koncertor në Ballkan organizuar në sallën e madhe të Koncerteve të UART një koncert prestigjioz me orkestrën filarmonisë e Universitetit Anadolu në 09 Korrik 2013.
- ii. Në Janar 2013 u realizua takimi i Rektorit Prof. Malaj me Ambasadorin e Republikës Serbe në Tiranë Sh.K.T. Z. Miroljub ZARIĆ. Ky takim ishte i frytshëm për rifreskimin e marrëdhënieve me këtë institucion dhe për të rivendosur kontaktet me Universitetin e Arteve në Beograd dhe për të mundësuar lidhjet me institucione të tjera të artit në Serbi. Këto kontakte do të arrinin të realizoheshin më pas gjatë vitit me një vizitë t Rektorit Malaj në Serbi nëpër këto institucione.
- iii. Në Mars 2013 u realizua takim me Zv.Ambasadorin Izraelit Z. Avraham Lev-Louis me rektorin Prof. Malaj, ku u vendosën lidhjet e bashkëpunimit dhe më pas gjatë vitit në 31 Tetor u realizua për studentët e Fakultetit të Artit Skenik dhe për studentët e Multimedias në Fakultetin e Arteve të Bukura, një seminar me Producentin e mirënjohur në botë dhe Drejtorin Ekzekutiv të Arkivës së Filmit në Izrael, Z. Katriel Schory.
- iv. Në Mars 2013 u vendosën kontaktet me Universitetin e Pejës dhe Fakultetin e Arteve pranë këtij Universiteti, dhe më pas u realizua në Tiranë një takim njohjeje dhe vendosjeje bashkëpunimi i Rektorit të Universitetit të Arteve, Prof. Petrit Malaj me Rektorin e Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Dr.SC. Armand Krasqini. Ky takim u finalizua me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi mes dy universiteteve duke hapur kështu rrugën e bashkëpunimit të Fakultetit të Arteve të Pejës dhe Universitetit të Arteve në Tiranë për bashkëpunim mes dy institucioneve.
- v. 15 Mars 2013 - Rektori i Universitetit të Arteve, Prof. Petrit Malaj takoi delegacionin nga Fakulteti i Arteve të Universitetit të Prishtinës, të përbërë nga Dekani Prof. Asoc. Adem Rusinovci, Zv. Dekanët, Prof.Asoc. Hajrush Fazlliu dhe Prof. Asoc. Hazir Haziri, dhe Pedagogia e Fakultetit të Arteve në Prishtinë, Prof. Asoc. Majlinda Kelmendi. Ky takim u organizua në kuadër të bashkëpunimeve për organizimin e aktivitetit "Ura me tri Harqe". Ky aktivitet tashmë është kthyer në një ritual, ku shkollat e larta të artit në tre vendet shqipfolëse, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni organizojnë aktivitete të përbashkëta në fusha të ndryshme të artit, duke krijuar kështu mundësi te reja

bashkëpunimi midis institucioneve por në të njëjtën kohë duke krijuar edhe mundësi promovimi dhe njohjeje brezit e ri të artistëve studentë.

- vi. Në 05 Prill takim i Rektorit Prof. Malaj me Ambasadorin Mario Bova, mbi mundësitë e bashkëpunimit të UART me Akademia Kombëtare e Artit Dramatik "Silvio d'Amico" në Romë.
- vii. Në vijimësi të takimit me Z. Bova dhe mbas shumë kontaktesh dhe letër-shkëmbimesh me Akademinë në Romë u arrit të realizohej në 28 Qershor – 2 Korrik takimi i Rektorit, Prof. Malaj, me drejtorin e Akademisë Silvio d'Amico, Z. Lorenzo Salvati. Akademia Kombëtare e Artit Dramatik "Silvio d'Amico" është një institucion prestigjioz, e cila është pjesë e një rrjeti të gjerë institucionesh të Artit në Evropë si dhe anëtare e shoqatës Evropë: Bashkimi i Shkollave të Teatrit dhe Akademive - E:UTSA, ku UART u sugjerua për të aplikuar si anëtare dhe menjëherë pas takimit është dërguar Statuti i kësaj shoqate dhe po përgatiten procedurat për anëtarësimin e UART në shoqatë E:UTSA si dhe nënshkrimi i marrëveshjes me këtë akademi.
- viii. Pas një seri takimesh të organizuar me Ambasadorin dhe përfaqësues të tjerë të ambasadës Hungareze në Shqipëri, u arrit që të vendoseshin kontakte të UART me Akademinë e Muzikës Liszt në Budapest. Për këtë arsye Rektori Prof. Malaj dhe Zv. Rektori Prof. Llozi, zhvilluan takime në Budapest me rektorin e kësaj Akademie, dhe ku u arrit të nënshkruhej dhe marrëveshja e bashkëpunimit.
Gjithashtu me Ambasadën Hungareze u organizua dhe një aktivitet i rëndësishëm, Koncerti Ekskluziv i Platformës Kulturore të Evropës Qendrore në 25 Nëntor ku luajtën 5 muzikantë nga vendet e platformës. Duke qenë se Hungaria ishte anëtare e kësaj Platforme bashkëpunoi ngushtë me UART, ku zyra e DMJ ishte dhe koordinatore për organizimin e këtij koncerti të rëndësishëm, pasi në këtë koncert ishin të ftuar të vecantë dhe përfaqësues të qeverive respektive por dhe përfaqësues diplomatikë të tjerë në Shqipëri. Ky event ishte dhe një mundësi e mirë për të vendosur apo për të rifreskuar marrëdhëniet me disa prej këtyre përfaqësuesve. I tillë ishte dhe takimi i me Ambasadorin e ri të Austrisë, me të cilit u fol për projekte të mundshme gjatë vitit 2014.
- ix. Në 28 Tetor u zhvillua takimi me Ambasadorin e Iranit, dhe u vendosën kontakte dhe u fol për mundësi lidhjesh me institucione të artit në Iran. Këto plane janë për t'u ndjekur gjatë vitit në vijim.
- x. Gjatë muajit Nëntor janë zhvilluar takime të rëndësishme me Drejtorin e TIKA (që është organizatë e qeverisë Turke për zhvillim) Prof. Dr. Birol Çetin. Prej shumë kohësh me këtë institucion qenë vendosur kontaktet nga DMJ dhe Zv, Rektori Prof. Asoc. Erald Bakalli dhe ishte aplikuar për mundësi pranimit të një projekti për përmirësim të ambienteve të UART. Në takimin e fundit me drejtorin Çetin u arrit të bihej dakord për sponsorizimin dhe ndërhyrjen e TIKA-s në përmirësimin e disa prej ambienteve të UART: Klasa mësimore, laborator për Skenografi-Kostumografinë dhe pajisje të Sallës së Madhe të koncerteve me poltrona të reja. Për realizimin e tyre do të punohet gjatë vitit 2014.

Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve dhe vendosjeje marrëdhëniesh janë bërë të mundur dhe shumë takime nga titullarë të UART në institucione arsimore dhe institucione të artit jashtë kufijve.

b. Marrëveshje Bashkëpunimi

Në 2013, janë nënshkruar dhe rinovuar 6 (gjashtë) marrëveshje bashkëpunimi me qëllim mundësimi të mobilitetit të studentëve dhe fakulteteve për mësimdhënieje, punë kërkimore, trajnime akademike dhe aktivitete kulturore-artistike me institucionet ndërkombëtare. MB janë nënshkruar me: 1- Universiteti Haxhi Zeka, Pejë, 2- Kolegji Profesional Privat "New Generation", 3- Universiteti i Arteve, Beograd, 4- Universiteti

Aristotel, Selanik, 5- Akademi e Muzikës Liszt, Budapest, 6- Këshilli Britanik në Tiranë. Këto angazhime tregojnë përpjekjet e UART për zgjerimin e partneriteteve strategjike me baza forta dhe të lehtësojnë mundësitë për fakultetet për të marrë pjesë në aktivitetet ndërkombëtare akademike dhe artistike. Gjithashtu UART është në proces për nënshkrim të 4 (katër) marrëveshjeve të tjera me: 1- Konservatori Çajkovski në Moskë, 2- Akademia e Arteve dramatike "Silvio D'Amico", Romë, 3- Universiteti i Seviljes, 4- Universiteti George Mason shkolla e Artit, Virxhinia.

c. Partnerë Strategjik

Partneritet strategjike kanë mundësuar zgjerimin e studimeve të studentëve tanë jashtë Shqipërisë, si: marrja pjesë e studentëve të degëve dhe specialiteteve të ndryshme në shkolla verore të organizuara nga Universitete partnere si: Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Beogradit, ANIMART në Greqi, gjithashtu nga marrëveshja me Universitetin Agder Norvegji, një student i Fakultetit të Muzikës arriti të fitojë një bursë për ndjekjen e programit të studimit Master në Kitarë dhe gjithashtu në bazë të bisedimeve të bëra së fundmi, do të shihet mundësia që në vitin 2014 jo vetëm që do të jepen bursa për studentë të UART por do të shihet dhe mundësia e rritjes së këtij numri.

Partner i rëndësishëm për UART janë dhe përfaqësitë diplomatike, si: Ambasada Hungareze, Ambasada Franceze, Këshilli Britanik, të cilat gjatë vitit 2013 kanë qenë shumë aktive në bashkëpunime me UART dhe në realizime projektesh të përbashkëta. Sigurisht realizimet e këtyre projekteve përkthehen në takime dhe komunikime të shumta që DMJ ka realizuar jo vetëm më këto institucione por edhe me institucionet bashkëpunuese me ta.

Qëllimi i vendosjes së lidhjeve me partnerë strategjik nëpër botë është shfrytëzimi i burimeve të limituara nëpërmjet rrjeteve me këta partnerë, dhe ne synojmë që vitin e ardhshëm këto rezultate të jenë në rritje. Për të arritur këtë qëllim, gjatë këtij vitit kjo degë ka punuar dhe vazhdon të punojë për të mundësuar përfshirjen e Universitetit të Arteve në projektet e programit të Komisionit Evropian, Tempus, në anëtarësimin e UART në rrjetin e shkollave dhe akademive të teatrit në Evropë E:UTSA.

III. Promovon punën akademike dhe artistike të UART dhe shpërndan nëpër Fakultetet e UART informacionin mbi aktivitete akademike, kërkimore, kulturore në sferën globale për personelin akademik dhe studentët

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë përgatit materialet për publikim në faqen e internetit të UART dhe për aktivitete ku është prezente media përgatit materialin për njoftimet e shtypit.

Aktivitete të rëndësishme për të cilat janë përgatitur dhe njoftimet për shtyp janë: aktiviteti Ura me Tri Harqe, Seminari për shkrimin e skenarit me profesorin francez Guy Mousset, Koncerti Ekskluziv i Platformës Kulturore të Evropës Qendrore.

Të gjitha takimet e rëndësishme të Rektorit si dhe aktivitete të rëndësishme që organizohen në Fakultete pasqyrohen në faqen e internetit të UART nga DMJ.

Kjo Degë është dhe kontakti kryesor i njoftimeve mbi aktivitetet që ndodhin në nivel vendi dhe ndërkombëtare. Duke pasur këtë parasysh kjo Degë mundëson shpërndarjen e informacionit në kohë për aktivitete të ndryshme dhe mundësi trajnimi për personelin. Kjo ka bërë të mundur pjesëmarrje të grupeve të ndryshme studentore në konkurse të ndryshme ndërkombëtare, ku kanë marrë dhe çmime, si; Konkursi Ndërkombëtar i Skulpturës në Itali ku studenti Bledian Ibrahimllari morri çmimin e parë; Festival of International Student Theatre – Festivali Ndërkombëtar i Studentëve të Teatrit i mbajtur në Beograd ku morri pjesë një grup prej 12 studentësh nga FAS

IV. Ndjek pjesëmarrjen e UART në Organizatat Ndërkombëtare dhe Shkollave të Artit në Botë

Për të mundur ecurinë sa më të mirë të marrëdhënieve me partnerët strategjik, Dega e Marrëdhënieve me Jashtë ndjek dhe procedurat e regjistrimeve dhe anëtarësimeve të përvitshme në Organizatat Ndërkombëtare. Aktualisht Universiteti i Arteve është i anëtarësuar në: AEC, Shoqata e Shkollave të Artit të Evropës Qendrore Jugore "Transform in art education".

Gjatë vitit 2013 kemi filluar procedurat për të mundur anëtarësim në E:UTSA (Shoqata e Shkollave dhe Akademive Evropiane të Teatrit), Social Portal: A window to the world (një rrjet partneriteti universiteteve Evropiane).

DMJ ndjek dhe mundëson informacionin për pjesëmarrjen e personelit të UART në aktivitetet e këtyre shoqatave.

Gjatë vitit 2013 titullarë të UART kanë marrë pjesë në 4 (katër) aktivitete ndërkombëtare si më poshtë:

- 1- 01 -03 Mars - Prof. Arben Llozi, Zv. Rektor i UART, mori pjesë në mbledhjen e parë administrative të AEC për vitin 2013, në Graz, Austri. Duke qenë se UART është anëtare e kësaj organizate ndërkombëtare e shkollave të muzikës në Evropë, kjo mbledhje ishte e rëndësishme për vendosjen e roleve dhe detyrave të anëtarëve të kësaj organizate.
- 2- 24 - 25 Maj, Rektori i Universitetit të Arteve, Prof. Petrit Malaj, së bashku me Zv/Rektorin, Prof. Asoc. Erald Bakalli, kanë qenë të ftuar në Konferencën e 3-të Ndërkombëtare SHARE në Bruksel, Belgjikë. Dy ditët e Konferencës ishin me interes për vendosje kontaktesh me shkolla të tjera të Artit në Evropë të cilat kanë hapur ciklin e tretë të studimit – doktoraturën, -për të mundur partneritete për të ardhmen duke qenë se UART është duke punuar për hapjen e këtij cikli të tretë studimi.
- 3- 29 – 30 Maj, Prof. Petrit Malaj, Retor i UART, Prof. Asoc. Erald Bakalli, Zv/Rektor i UART, Znj. Alma Sinanaj, Kancelare e UART, ishin ftuar nga Rektori i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për të marrë pjesë në Konferencën e Tretë Rajonale në datat 29.05.2013 – 30.05.2013.
- 4- 12 -15 Shtator, Prof. Sokol Shupo, Dekan i FM, mori pjesë në takimin vjetor të AEC për Koordinatorët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare me temë "Përgatitjet për partneritet: strategjitë dhe praktikat". Kjo mbledhje ishte me interes pasi u diskutua dhe mbi mundësitë e pjesëmarrjes së shkollës sonë në projekte Evropiane si dhe mbi programin e ri ERASMUS +, dhe mundësitë që ofrohen për shkollat e artit.

Trajnime dhe seminare

Përmirësimi dhe përditësimi me projektet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare është gjithashtu një prioritet i DMJ. Për këtë arsye gjatë vitit 2013 në bashkëpunim me partnerë si Këshilli Britanik dhe Zyra Tempus në Tiranë janë ndjekur seminare dhe prezantime të rëndësishme si më poshtë:

- 1- 28-31 Janar 2013 – seminari mbi Sipërmarrjen krijuese organizuar nga British Council, drejtuar nga Percy Emmett pjesë e NESTA Organization dhe konsulent i Këshillit Britanik në Londër. Ky seminar kishte në bazë krijimin e lidhjeve dhe organizimin e marrëdhënieve dhe vendosjen e bashkëpunimit në fushën e artit. Në këtë seminar merrnin pjesë artistë të fushave të ndryshme, menaxherë të artit në Shqipëri. Nga UART morën pjesë: përfaqësues i DMJ, Ina Myftiu, pedagogë - Taulanta Jupi, Prof. Asoc. Dr. Aneta Malaj, dhe kuratori i galerisë FAB, Ermir Hoxha.
- 2- 10 tetor 2013 - "Seminari kontaktit midis universiteteve të Suedisë dhe atyre të Ballkanit Perëndimor". Në këtë seminar morën pjesë nga UART: përfaqësues i DMJ, Ina Myftiu, zv/rektor Prof. Arben Llozi. Ky ishte një aktivitet i rëndësishëm ku fokusi kryesor ishte informimi mbi mundësitë e programit të ri Erasmus + që fillon në 2014, dhe bashkëpunime i Linnaeus-Palme.
- 3- 9 – 10 Dhjetor 2013, "Trajnim mbi menaxhimin e projekteve të Këshillit Evropian". Qëllimi kryesor i modulit të trajnimit ishte për të thelluar çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e projekteve të financuara nga BE (por edhe i projekteve të financuara nga organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare), dhe për këtë arsye për të analizuar opsionet e ndryshme të modeleve organizative në faza e zhvillimit të projektit.

KREU I KATËRT

ÇËSHTJE JURIDIKE

Dega Juridike në Universitetin e Arteve përbëhet nga një Kryetar Dege. Kjo Degë përfshin një sërë detyrash të karakterit administrativ, të cilat lidhen në mënyrë harmonike me veprimtarinë tërësore të Universitetit të Arteve.

Dega Juridike është e angazhuar kryesisht në:

- Përgatitjen e dokumentacionit administrativ/ligjor për veprimtarinë e Rektoratit / institucionit në tërësi.
- Përgatitjen e dokumentacionit të autoriteteve drejtuese;
- Përgatitjen e kontratave me të tretët;
- Përgatitjen e dokumentacionit në lidhje me marrëdhëniet ligjore të punësimit;
- Përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e prokurimit dhe monitorimi i këtyre procedurave;
- Ndjekja e çështjeve gjyqësore;

1. Dokumentacioni për veprimtarinë e Rektoratit/Institucionit

Veprimtaria e Rektoratit të Universitetit të Arteve materializohet nëpërmjet urdhrave, vendimeve e shkresave të Rektorit, duke rregulluar në këtë mënyrë si marrëdhëniet brenda institucionit ashtu edhe marrëdhëniet me të tretët.

Gjatë vitit 2013, nga Dega Juridike janë përgatitur më shumë se 150 shkresa, urdhra dhe vendime, si dhe një numër tjetër i konsiderueshëm prej këtyre akteve në bashkëpunim me struktura të tjera të UART. Kryesisht marrëdhëniet më të shpeshta rezultojnë të jenë mbajtur me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve), e cila përbën edhe partnerin kryesor në veprimtarinë akademike, shkencore e administrative për Universitetin e Arteve.

1.1. Zgjedhjet për autoritete dhe organe drejtuese

Gjatë vitit 2013 janë shpallur zgjedhjet në Universitetin e Arteve për zgjedhjen e Përgjegjësve të Njësive bazë në Fakultetin e Arteve të Bukura. Që prej vitit 2012, vit në të cilin u zhvilluan zgjedhjet për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetin e Arteve, pozicionet e Përgjegjësve të dy Njësive Bazë në Fakultetin e Arteve të Bukura, kanë mbetur vakante për shkak të mosparaqitjes së kandidaturave për këto pozicione. Në këto pozicione

janë caktuar personel akademik i FAB, me Urdhër të Dekanit të Fakultetit, për një periudhë njëvjeçare.

Me urdhrin nr. 482, datë 21.11.2013 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit është urdhëruar fillimi i procesit të zgjedhjeve të pjesëshme në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik. Ky proces është caktuar të nisë në datën 21.11.2013, ndërsa data e zgjedhjeve është caktuar në datën 20.12.2013.

Mbi bazën e urdhrin të sipërpërmendur të MAS, Rektori i UART ka nxjerrë Urdhrin përkatës për shpalljen e zgjedhjeve dhe më tej Senati Akademik i Universitetit të Arteve ka miratuar Vendimin nr. 15, datë 27.11.2013, me të cilin përcaktohen procedurat për zhvillimin e zgjedhjeve për Përgjegjësit e dy Njësive Bazë në FAB.

Në përputhje me procedurat e përcaktuara, KOZI ka filluar punën duke miratuar Vendimin nr. 1, datë 28.11.2013 për shpalljen e procedurave zgjedhore. Pas kalimit të afateve për regjistrimin e kandidatëve, KOZI ka konstatuar se nuk është paraqitur asnjë kandidat për zgjedhjet për pozicionet e Përgjegjësve të Njësive Bazë në FAB. Si rrjedhojë KOZI ka vendosur moszhvillimin e zgjedhjeve me Vendimin nr. 2, datë 05.12.2013.

2. Dokumentacioni i Autoriteteve drejtuese

Dokumentacioni i Autoriteteve Drejtuese përfshin kryesisht Vendime të Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit, së bashku me praktikën përkatëse që referojnë marrjen e vendimeve. Gjatë vitit 2013 janë hartuar praktikën dhe projektvendimet për 16 Vendime të Senatit Akademik dhe disa Vendime të Këshillit të Administrimit.

Vendimmarrja e Senatit Akademik në tërësinë e vet paraqet rëndësi për mbarëvajtjen e procesit akademik në Universitetin e Arteve.

Çështjet më të rëndësishme të cilat janë bërë objekt i vendimmarrjes së Senatit Akademik gjatë vitit 2013, ndër të tjera, kanë qenë:

- Struktura e personelit akademik (personeli i brendshëm dhe i ftuar e me kontratë);
- Miratimi i rregulloreve të konkurseve të pranimit në programet e studimit.
- Miratim i rregulloreve mësimore të ciklit të parë e të dytë.
- Çështje të zgjedhjes së autoriteteve drejtuese.

- Ngritje komisioni për dhënie titujsh akademik.
- Ndryshimi i Statutit të UART

Vendimmarrja e Këshillit të Administrimit në tërësinë e vet paraqet rëndësi për mbarëvajtjen e procesit administrues në Universitetin e Arteve. Çështjet më të rëndësishme të cilat janë bërë objekt i vendimmarrjes së Këshillit të Administrimit gjatë vitit 2013 kanë qenë ato me karakter financiar e rregullator financiar, duke veçuar vendimmarrjen lidhur me dhënien e mjediseve me qira për të tretë.

3. Përgatitja e kontratave

Veprimtaria e Universitetit të Arteve me të tretët realizohet nëpërmjet vendosjes së rregullave të marrëdhënieve juridike, të cilat kanë karakteristika të ndryshme në varësi të llojit të veprimtarive që përfshihen në marrëdhëniet konkrete. Të gjitha marrëdhëniet juridike me të tretët rregullohen nëpërmjet kontratave të lidhura mes palëve. Çështjet kryesore të cilat rregullohen nëpërmjet kontratave janë:

- Blerjet e kryera nga UART;
- Kontratat administrative të prokurimit;
- Kontratat e dhënies me qira;
- Kontratat e punësimit
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit.

Dega Juridike ka hartuar kontrata tip për rregullimin e marrëdhënieve juridike në rastet e blerjeve të vogla dhe në marrëdhëniet juridike të punësimit (ku përfshihen: punësimi i personelit administrativ, punësimi i personelit akademik të përhershëm dhe punësimi i personelit akademik të përkohshëm). Këto modele i janë paraqitur DBNJ.

Në rastet e procedurave të prokurimit, Dega Juridike ka hartuar Kontratat administrative të prokurimeve, rast pas rasti, duke u bazuar në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të tenderit, në përputhje me Dokumentet Standarde të Tenderit. Gjatë vitit 2013 janë hartuar kontrata administrative të prokurimeve, si vijon:

- Kontratë për sigurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike lidhur me shoqërinë Oktapus Security sh.p.k. për nevoja të fillim vitit.
- Kontratë për sigurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike lidhur me shoqërinë Oktapus Security sh.p.k. për nevoja emergjente me afat 2 muaj.
- Kontratë për sigurimin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike lidhur me shoqërinë Jori sh.p.k. përgjatë vitit 2013.
- Kontratë për rikonstrukcion tarracash me shoqërinë Suka sh.p.k.
- Kontratë shtesë për rikonstrukcion tarracash me shoqërinë Suka sh.p.k.

- vi. Kontratë blerje lëndë djegëse për ngrohje me shoqërinë Europetrol sh.a. (sipas të dhënave ardhur nga Organi Qendror Blerës).

Gjatë vitit 2013, kanë qenë efektive kontrata të dhënies së mjediseve të UART me qira dhe/ose enfiteozë, në përputhje me Vendimin përkatës të Këshillit të Administrimit:

- a. Kontratë qiraje me shoqërinë Vodafone Albania sh.a.
- b. Kontratë qiraje me shoqërinë Eagle Mobile sh.a. (Albtelecom sh.a.)
- c. Kontratë qiraje me shoqërinë Corner sh.p.k.

Universiteti i Arteve ka pasur marrëdhënie të ngushta me institucione të tjera homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me të cilat ka zhvilluar marrëdhënie të bashkëpunimit reciprok. Me mjaft institucione janë nënshkruar vitet e mëparshme marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë rregulluar marrëdhëniet e përbashkëta.

Nërkohë gjatë vitit 2013, janë nënshkruar disa Marrëveshje Bashkëpunimi, si me:

- Teatrin e Durrësit "Aleksandër Moisiu";
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (në kuadër të partneritetit për projektin (artvision - a.live art channel);
- Këshillin Britanik;
- Institucionin Arsimit Privat "New Generation".

4. Procedurat e prokurimit

Gjatë vitit 2012 në Universitetin e Arteve janë zhvilluar 4 procedura prokurimi¹, të cilat janë finalizuar me lidhje kontratash dhe sigurimin e mallrave apo shërbimeve. Procedurat e prokurimit janë si vijon:

- a. Procedurë e prokurimit negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për sigurimin e shërbimit të ruajtjes me roje private, me qëllim plotësimin e nevojave të fillim vitit 2013.
- b. Procedura e prokurimit kërkesë për propozim, elektronike për sigurimin e shërbimit të ruajtjes me roje private për vitin 2013;
- c. Procedurë e prokurimit negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës për sigurimin e shërbimit të ruajtjes me roje private, me qëllim plotësimin e nevojave


¹ Nuk përfshihen procedurat e prokurimit me blerje të vogla

emergjente me afat maksimal dy mujor, deri në lidhjen e kontratës sipas procedurës normale të prokurimit.

- d. Procedura e prokurimit për rikonstrukcion tarracash;
- e. Procedurë prokurimi negocim pa shpallje për punime shtesë për rikonstrukcion tarracash.
- f. Procedura e prokurimit kërkesë për propozim, elektronike për blerjen e pajisjeve audiovizuale.

Dokumentacioni i tenderit është hartuar, për të gjitha procedurat e prokurimit, nga ana e Njesisë së prokurimit, me përfshirjen në hartimin e specifikimeve të specialistëve përkatës, sipas fushës që përfshin objekti i tenderit. Në procedurat e tenderimit vlerësimi është bërë nga KVO-ja përkatëse e ngritur me urdhër të Rektorit të UART, për çdo rast. Në procedurat e prokurimit janë përfshirë gjatë këtij viti 9 persona si anëtarë të komisioneve të prokurimit.

Tabelë treguese për procedurat e prokurimit 2013						
Lloji i Procedurës	Fondi limit (pa TVSH)	Nr. Anëtarëve të KVO	Nr. Ofertuesve	Fituesi	Data e kontratës	Vlera e kontratës
Shërbim roje për nevoja të fillim vitit 2013						
Negocim pa shpallje	N/A	N/A	1	Oktapus Security sh.p.k.	31.12.12	589.680
Shërbim roje për vitit 2013						
Kërkesë për propozim, e-tender	2.420.667	3	13	Jori Security sh.p.k.	05.07.13	2.016.233
Shërbim roje për nevoja urgjente me afat 2 muaj						
Negocim pa shpallje	605.166	3	3	Oktapus Security sh.p.k.	19.04.13	726.192
Rikonstrukcion tarraca						
Kërkesë për propozim, e-tender	1.493.796	3	10	Suka sh.p.k.	20.05.13	1.080.326
Punime shtesë rikonstrukcion tarraca						
Negocim pa shpallje	179.795	3	1	Suka sh.p.k.	25.06.13	215.754



Gjithashtu një procedurë prokurimi është realizuar nga Organi Qendror Blerës, me objekt "Blerje lëndë djegëse për ngrohje". Universiteti i Arteve ka lidhur Kontratën e furnizimit për lëndë djegëse gazoil me Shoqërinë Europetrol Durrës Albania sh.a., në përputhje me autorizimin e OQB nr. 26/7, datë 17.08.2013. Kontrata është lidhur në datën 03.09.2013, për vlerën 2.304.230 (dy milion e treqind e katër mijë e dyqind e tridhjetë) lekë, me T.V.SH., me marzh fitimi 19,35 (nëntëmbëdhjetë presje tridhjetë e pesë) lekë/litër.

5. Çështje gjyqësore dhe të ngjashme

Gjatë vitit 2013 Universiteti i Arteve ka qenë palë në disa konflikte gjyqësore, të cilat janë gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë si dhe e dy procedimeve administrative të zhvilluar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbi bazën e ankimeve të ngritura nga znj. Ina Kosturi.

Konfliktet gjyqësor lidhen me marrëdhënie kontraktuale civile, çështje punësimi e çështje administrative.

Tabelë treguese për konfliktet ku UART ka qenë palë - 2013					
Nr. çështje	Paditës	I paditur (Ps. 3)	Gjyqtari	Objekti	Shënime
2624	Universiteti i Arteve	Euroil sh.a.	Valdete Hoxha, Ilir Toska, Edlira Petri	Kthim shume	Gjykata e Apelit Tiranë, lënë në fuqi Vendimi
13064	Ina Kosturi	Universiteti i Arteve	Bledar Abdullai	Marrëdhënie pune	Gjykata e RRGJ Tiranë, në proces
17176	Sokol	Universiteti i	Asim Vokshi	Kundërshtim	Gjykata e RRGJ

	Shupo	Arteve		akti administrativ	Tiranë, në proces
2694	Redis Ranxha	Universiteti i Arteve (Ps. 3)	Florjon Kalaja	Korrigjim aktesh	Gjykata e RRGJ Vlorë. Pranuar
16824	Ilia Kanani	Universiteti i Arteve	Enkela Bajo (Vlora)	Korrigjim aktesh	Gjykata e RRGJ Tiranë, në proces
13481	Universiteti i Arteve	Komisioni i Prokurimit Publik	Anila Kristani	Shfuqizim akti administrativ	Gjykata e RRGJ Tiranë, në proces
28	Ina Kosturi	Universiteti i Arteve	Komisioneri Irma Baraku	Diskriminim	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Konstatuar diskriminim

Në referim të konfliktit të ngritur për shqyrtim përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga diskriminimi gjatë vitit 2013, ky institucion ka dhënë Vendimin nr. 102, datë 18.10.2013, me të cilin konstaton diskriminimin e znj. Ina Kosturi për shkak të ideve dhe qëndrimeve kritike, në lidhje me mospërfshirjen e saj në komisionet e provimeve të studentëve. Komisioneri rekomandon Dekanin e Fakultetit të Muzikës të marrë masa për zbatimin e Rregullores Mësimore të ciklit të parë të studimeve lidhur me zbatimin e rregullave për realizimin e procesit të provimeve, duke përfshirë ankuesen Ina Kosturi në Komisionet e Provimeve për studentët e saj.

Me vendimin e sipërcituar Komisioneri ka dhënë edhe disa rekomandime që lidhen me përcaktimin e procedurave të qarta lidhur me zhvillimin e Stinës Koncertore, si dhe me marrjen e masave për shqyrtimin në mënyrë efektive të ankesave për diskriminim nga punëmarrësit.

Në vijim është nxjerrë urdhri nr. 91, datë 08.11.2013 "Për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të përcaktuara në Vendimin nr. 102, datë 18.10.2013", me të cilin përcaktohen hapa konkret për zbatimin e rekomandimeve të KMD. Në referim të përmbushjes së rekomandimeve, Senati Akademik i UART ka miratuar² disa ndryshime në Statutin e UART, duke përcaktuar Këshillin e Etikës dhe Rektorin si autoritete përgjegjëse gjatë shqyrtimit të çështjeve të diskriminimit në UART. Gjithashtu nga ana e Fakultetit të Muzikës është miratuar një rregullore për organizimin dhe

² Vendimi nr. 16, datë 18.12.2013 i Senatit Akademik të UART

funksionimin e Stinës Koncertore. (Shiko shkresën nr. 1645 prot., datë 27.12.2013 dërguar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi).

Lidhur me çështjet e mëparshme gjyqësore, të ngritura gjatë vitit 2012 dhe të përfunduara gjatë vitit 2013, të dhënat paraqiten në tabelën në vijim.

Tabelë treguese për konfliktet gjyqësore 2012 të përfunduara në 2013					
Nr. çështje	Paditës	I paditur	Gjyqtari	Objekti	Përfundimi
10954	Universiteti i Arteve	Euroil sh.a.	Elona Stavri	Kthim shume	Pranuar
12143	Sokol Shupo	Universiteti i Arteve	Rilinda Selimi	Kundërshtim akti administrativ	Rrëzuar
21	Ina Kosturi	Universiteti i Arteve	Irma Baraku – KMD	Diskriminim	Mospranim

Përfundimi i shqyrtimit të çështjes UART vs Euroil sh.a. me objekt “Kthim shume dhe shpërblim dëmi”, edhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, i hap rrugë kërimit nëpërmjet shërbimit të përbarimit gjyqësor të shumës së përcaktuar me Vendim gjyqësor.

6. Praktika lidhur me përjashtimin nga detyrimi për pagesën vjetore të shkollimit

Universiteti i Arteve, duke qenë një institucion i arsimit të lartë publik, zbaton përcaktimet e vendimeve të Këshillit të Ministrave që lidhen me përcaktimin e kuotave dhe tarifave të shkollimit, si dhe shqyrton rastet e përjashtimit nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit. Për vitin akademik 2013 – 2014 ky proces është rregulluar nga VKM nr. 565, datë 27.06.2013³, që i referohet ciklit të parë të studimeve dhe VKM nr. 744, datë 05.09.2013⁴ që i referohet ciklit të dytë të studimeve. Gjithashtu rregullime të posaçme

³ Pika 9 e VKM 565 përcakton: Kandidatët, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin e ri akademik 2013 – 2014, si dhe studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si: personat që nuk shikojnë/personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentët, të cilëve njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore dhe ata që vijnë nga “familje në nevojë”, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.

⁴ Pika 14 e VKM 744 përcakton: Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013 - 2014 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë/personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë


bëhen edhe nga neni 75, pika 6⁵ e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar. Gjithashtu VKM nr. 565, datë 27.06.2013, në pikën 11 të tij parashikon përjashtimin nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit për tre studentët me rezultatet më të larta në konkurset e pranimit (sistemi meritë - preferencë), në rang Fakulteti. Për rregullimin e procesit të aplikimit, është hartuar praktika përkatëse e aplikimit për studentët, praktikë e cila është miratuar me Urdhër nr. 55, datë 19.09.2013 të Rektorit të UART. Kjo praktikë siguron transparencë në kriteret e përcaktuara si dhe lehtësi në realizimin e aplikimit. Gjithashtu sigurohet një përcjellje e saktë e informacionit, duke bërë që të gjitha hallkat e përfshira të kenë informacionin e nevojshëm dhe studenti të njihet me vendimin lidhur me pranimin apo refuzimin e kërkesës.

Gjatë vitit akademik 2013 – 2014 janë paraqitur 139 aplikime nga studentët, nga të cilat 104 janë pranuar dhe 35 janë refuzuar.



Tabelë treguese e aplikimeve për përjashtim nga tarifa vjetore 2013 - 2014			
Kriteret	Nr. Aplikimeve	Pranuar	Refuzuar
Studentë që nuk shikojnë / nuk dëgjojnë	3	2	1
Student që vjen nga shtresa sociale: invalidë pune dhe fëmijët e tyre, invalidë paraplegjikë apo tetraplegjikë dhe fëmijët e tyre	59	47	12
Student që vjen nga shtresa sociale: jetimë (kur të dy prindërit kanë ndërruar jetë)	1	1	0
Student të cilit njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familja e tij përfiton ndihmë ekonomike nga njësia e qeverisjes vendore ose vjen nga "familje në nevojë"	18	6	12
Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë romë / ballkano egjiptianë	27	27	0
Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë nga prindër të dënuar politik me heqje lirie	5	2	3
Student që vjen nga shtresa sociale: fëmijë të policëve e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës	1	1	0
Student i prekur nga sëmundja HIV-AIDS	0	0	0
Student i shkëlqyer apo student me Medalje Ari	25	18	7
GJITHSEJ	139	104	35

dhe fëmijët e tyre, jetimët, studentët të cilëve njëri nga prindërit i është ndarë nga jeta dhe familjet e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike nga njësitë e qeverisjes vendore si "familje në nevojë", fëmijët romë, ballkano-egjiptianë, fëmijët nga prindër të dënuar politikë me heqje lirie, fëmijë të policëve e të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të prekurit nga sëmundja HIV-AIDS, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit.

⁵ "Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës."



Nga 104 aplikimet e pranuar, për 69 studentë është miratuar përjashtimi i plotë nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa për 35 studentë është miratuar përjashtim i pjesshëm.



Nga këto të dhëna rezulton se nga 1270 studentë të regjistruar në Universitetin e Arteve aktualisht, 69 studentë ose 5 % janë përjashtuar plotësisht nga tarifa e shkollimit dhe 35 studentë ose 3% janë përjashtuar pjesërisht nga tarifa e shkollimit.

KREU I PESTË

ADMINISTRIMI FINANCIAR

Buxheti i shpenzimeve për tu realizuar nga Universiteti i Arteve, për vitin 2013, me burim financimi buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e vetë institucionit, ishte parashikuar të ishte si në tabelën e mëposhtme:

Art.	Emërtimi	Kapitulli 1	Kapitulli 6	Kapitulli 8	TOTALI
231	Investime	-	2,533,885	-	2,533,885
600	Paga	-	30,546,000	205,433,945	235,979,945
601	Sigurime shoqer. dhe shendet.	-	350,000	30,246,447	30,596,447
602	Mallra dhe sherbime te tjera	-	24,099,780	-	24,099,780
605	Transferimet korrente jashte	-	120,000	-	120,000
606	Bursa per studentet	3,950,000	-	-	3,950,000
606	Transferta per buxhetet e individ.	-	1,080,000	150,000	1,230,000
	TOTALI	3,950,000	58,729,665	235,830,392	298,510,057

Shënime:

1. Kapitulli 1 – jane fonde te akordura nga buxheti i shtetit për bursa për studentët


2. Kapitulli 6 – janë të ardhura të parashikuara për të u realizuar gjatë vitit 2013 me vlerë 51.064.698 lek si të ardhurat e trashëguara të pashfrytezuara nga viti 2012 me vlerë 7.664.967 lek.

3. Kapitulli 8 – jane fonde te dhena ne forme granti nga buxheti i shtetit per paga dhe shpenzime operative.

Gjatë vitit 2013, nuk u realizuan të ardhurat në vlerën e parashikuar (shkaqet do të trajtohen në vijim) dhe si pasojë buxheti, i cili ishte në dispozicion, është në tabelën e mëposhtme.

Art.	Emertimi	Kapitulli 1	Kapitulli 6	Kapitulli 8	TOTALI
231	Investime	-	2,533,885	-	2,533,885
600	Paga	-	30,546,000	205,433,945	235,979,945
601	Sigurime shoqer. dhe shendet.	-	350,000	30,246,447	30,596,447
602	Mallra dhe sherbime te tjera	-	22,424,608	-	22,424,608
605	Transferimet korrente jashte	-	120,000	-	120,000
606	Bursa per studentet	3,950,000	-	-	3,950,000
606	Transferta per buxhetet e individ.	-	1,045,000	150,000	1,195,000
	TOTALI	3,950,000	57,019,493	235,830,392	296,799,885


Pesha specifike që ze çdo kapitull i buxhetit, në buxhetin total, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Realizimi i buxhetit te shpenzimeve te Universitetit te Arteve, per vitin 2013, eshte paraqitur si me poshte:

Art.	Emertimi	Plani Viti 2013	Fakti Viti 2013	Diferenca P-F	% e realizimit
231	Investime	2,533,885	1,731,414	802,471	68%
600	Paga	235,979,945	233,974,227	2,005,718	99%
601	Sigurime shoqerore dhe shendet.	30,596,447	30,572,285	24,162	100%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	22,424,608	21,738,104	686,504	97%
605	Transferimet korrente jashte	120,000	120,000	-	100%
606	Bursa per studentet	3,950,000	3,686,172	263,828	93%
606	Transferta per buxhetet e individ.	1,195,000	1,040,000	155,000	87%
TOTALI		296,799,885	292,862,202	3,937,683	99%

Pesha specifike e cdo zeri te shpenzimeve, ne shpenzimet totale te realizuara gjate vitit 2013, eshte paraqitur ne grafikun e meposhtem:



INVESTIME (231)

Buxheti per investime i parashikuar dhe realizuar, ne Universitetin e Arteve per vitin 2013, eshte paraqitur ne tabelen e meposhtme:

Nr.	Emertimi	Plani Viti 2013	Fakti Viti 2013	Diferenca P-F	% e realizimit
1	Rikonstruksioni tarraca	1,792,535	1,296,054	496,481	72%
2	Supervizion-kolaudim tarraca	61,350	28,800	32,550	47%
3	Blerje kondicioner	480,000	406,560	73,440	85%
4	Riparim makine transporti	200,000	-	200,000	0%
	TOTALI	2,533,885	1,731,414	802,471	68%

- Mosrealizimi i buxhetit ne zerat e investimeve nga Nr. 1-3 kane ardhur si rrjedhoje e raportit kerkese-oferte, mbasi perzgjedhja e fituesve per realizimin e ketyre investimeve eshte mbeshtetur ne procedurat e prokurimit publik.
- Mosrealizimi i buxhetit ne zerin "Riparim makine" ka ardhur si pasoje se per makinen, gjate vitit 2013, lindi nevoja per riparime shtese nga ato te parashikuara, keshtu qe u pa e arsyeshme qe, riparimi te mos behej pjesor, sepse mund te rezultonte joeficient ne terma afatgjate.

PAGA (600)**SIGURIMET SHOQERORE DHE SHENDETESORE (601)**

Art.	Emertimi	Plani Viti 2013	Fakti Viti 2013	Diferenca P-F	% e realizimit
600	Paga	235,979,945	233,974,227	2,005,718	99%
601	Sigurime shoqer. dhe shendet.	30,596,447	30,572,285	24,162	100%
	TOTALI	266,576,392	264,546,512	2,029,880	99%

Zeri "Paga" ka patur mosrealizim per arsye se fondi i planifikuar per shperblim (10.000 lek/punonjes) ne fund te vitit 2013, nuk u dha sepse me VKM u pezullua.

MALLRA DHE SHERBIME (602)

Nr. Llog.	Emertimi	Plani (P) Viti 2013	Fakt (F) Viti 2013	Diferenca P-F	% e realizimit
6020	Mallra dhe sherbime te tjera	1,363,588	1,235,532	128,056	91%
6021	Materiale dhe sherbime speciale	383,980	366,680	17,300	95%
6022	Sherbime nga te trete	14,890,205	14,709,697	180,508	99%
6023	Shpenzime transporti	217,835	217,835	-	100%
6024	Shpenzime udhetimi	780,000	773,102	6,898	99%
6025	Shpen. per mirembajtje te zakonshme	90,000	73,800	16,200	82%
6029	Shpenzime te tjera operative	4,699,000	4,361,458	337,542	93%
	TOTALI	22,424,608	21,738,104	686,504	97%

- Zeri “Mallra dhe sherbime te tjera”, “Materiale dhe sherbime speciale” dhe “Shpen. per mirembajtje te zakonshme” - kane ardhur si rrjedhoje e raportit kerkese-oferte, mbasi perzgjedhja e fituesve per realizimin e ketyre investimeve eshte mbeshtetur ne procedurat e prokurimit publik.
- Zeri “Sherbime nga te tretet” - mosrealizimi kryesisht ka ardhur si pasoje se eshte konsumuar energji elektrike, uje dhe shpenzime telefonike me pak nga sa ishte parashikuar. Parashikimi ishte realizuar bazuar ne shpenzimet e realizuara gjate vitit 2012.
- Zeri “Shpenzime te tjera operative” - mosrealizimi ka ardhur si pasoje se megjithese u realizuan procedurat e prokurimit publik per blerjen e materialeve per laboratorin tekstilit dhe modes si dhe laboratorin e qeramikes, asnje nga fituesit nuk i perfundoi proceduren.

TE ARDHURAT


Te ardhurat e realizuara nga Universiteti i Arteve, gjate vitit 2013, jane si ne vijim:

Nr.	Burimi i krijimit i te ardhurave	Parashikimi Viti 2013	Realizimi Viti 2013	Diferanca P-F	% e realizimit
1	Tarifa Shkollimi	43,274,746	40,808,102	2,466,644	94%
2	Sherbim sale	2,400,000	3,135,000	(735,000)	131%
3	Konkurse pranimi	2,000,000	2,310,000	(310,000)	116%
4	Qera ambjente	2,029,952	2,214,877	(184,925)	109%
5	Libreza e diploma	500,000	260,000	240,000	52%
6	Tarifa regjistrimi	800,000	388,800	411,200	49%
7	Vërtetime, Shtypshkrime, etj	60,000	137,697	(77,697)	229%
8	Arketim nga debitoret		100,050	(100,050)	#DIV/0!
TOTALI		51,064,698	49,354,526	1,710,172	97%

Mosrealizimi ka ardhur nga zerat te cilet jane analizuar ne vijim:

- Zeri “Tarifa shkollimi” - mosrealizimi ka ardhur si pasoje se numri i studenteve te cilet mund do te perjashtoheshin nga tarifa e shkollimit ose do te kishin nje reduktim te saj(50%) ishte parashikuar te ishte 71 studente kur ne fakt, gjate vitit 2012-2013, pati 161 studente (nga te cilet 63 rezultojne te larguar nga UART).
- Zeri “Tarifa regjistrimi” –ne VKM-të per konkurset dhe pranimin ne universitete te dale ne Shtator 2013, ndryshe nga VKM-te e vitit 2012, ishte hequr tarifa per rregjistrim ne konkurset e pranimit te studenteve ne ciklin II (Master) me vlere 2.500 lek. Parashikimi per kete ze ishte parashikuar bazuar ne VKM-te e vitit 2012 duke sjelle si pasoje mosrealizimin e tij.

Pesha specifike qe ze cdo burim, ne te ardhurat totale te realizuara gjate vitit 2013, eshte paraqitur ne grafikun e meposhtem:



KREU I GJASHTË

AUDITIMI

1. AUDITIMI I BRENDSHËM

Objekt i auditimit të brendshëm janë të gjitha vendimet financiare për të ardhurat, shpenzimet, administrimin e pasurive (aseteve) dhe borxheve. Auditimi i brendshëm, si një proces dhe veprimtari e pavarur nga pikëpamja funksionale, vlerëson funksionimin e drejtimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozon masa, për të përmirësuar funksionimin dhe drejtimin e subjekteve të audituara.

Në fillim të vitit 2013 është miratuar një program auditimi vjetor nga Rektori i Universitetit të Arteve⁶, program i cili përmban një sërë tematikash, si më poshtë:

- a. Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimin e tarifës së shkollimit.
- b. Auditim mbi zbatimin e procedurave të pranimit dhe regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.
- c. Auditim I procedurave të krijimit të të ardhurave.
- d. Auditim mbi përfundimet e auditimit të mëparshëm që është kryer lidhur me rregullshmërinë e pagesës së modeleve që pozojnë gjatë procesit akademik në UART.
- e. Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë për bursat dhe përdorimin e fondit të bursave.
- f. Zbatimi I procedurave ligjore në llogaritjen dhe shpërndarjen e pagave.
- g. Ligjshmëria e kryerjes së veprimit e arkëtimit dhe e pagesave ndërmjet arkës dhe bankës.
- h. Auditimi mbi buxhetin.
- i. Investimet, blerjet dhe prokurimet.
- j. Te ndryshme.

Auditimi me tematikë "Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet brenda afateve të tarifës së shkollimit si dhe zbatimin e procedurave të pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë për vitin akademik 2012-2013", u realizua në Universitetin e Arteve nga data 22.01.2013 deri më datë 15.02.2013. Në përfundim të këtij auditimi kanë rezultuar të dhënat e mëposhtme:

⁶ Dokumenti me Nr. 83 prot., datë 22.01.2013

- a. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 1006 student të ciklit të parë dhe të dytë, nga të cilet 82 janë përjashtuar nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, 21 studentë janë me pagesë të pjesshme të tarifës së shkollimit, 482 kanë paguar tarifën e shkollimit dhe 442 janë pa paguar dhe të ndarë përkatësisht si më poshtë vijon:
- I. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 209 studentë në ciklin e parë të studimeve viti i parë dhe 154 studentë kanë derdhur tarifën e shkollimit, 17 studentë janë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit si dhe 38 studentë pa paguar tarifën e shkollimit.
 - II. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 249 studentë në ciklin e parë të studimeve viti i dytë dhe 117 studentë kanë derdhur tarifën e shkollimit, 13 studentë janë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit si dhe 119 studentë pa paguar tarifën e shkollimit
 - III. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 255 studentë në ciklin e parë të studimeve viti i tretë dhe 123 studentë kanë derdhur tarifën e shkollimit, 26 studentë janë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit si dhe 106 studentë pa paguar tarifën e shkollimit]
 - IV. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 268 studentë në ciklin e dytë të studimeve viti i parë dhe 47 studentë kanë derdhur tarifën e shkollimit, 18 studentë janë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit si dhe 103 studentë pa paguar tarifën e shkollimit
 - V. Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 125 studentë në ciklin e dytë të studimeve viti i dytë dhe 43 studentë kanë derdhur tarifën e shkollimit, 8 studentë janë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit si dhe 74 studentë pa paguar tarifën e shkollimit

Auditimi mbi procedurat për pranimin në ciklin e parë të studimeve sipas udhëzimit nr. 23 datë 14.09.12 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë si dhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2012-2013", ka nxjerrë se janë regjistruar në ciklin e parë të studimeve 209 studentë dhe kanë derdhur tarifën e regjistrimit të 209-të studentët. Është i plotë dokumentacioni për çdo student të regjistruar sipas udhëzimit të sipërcituar, fotokopje e dokumentit të identifikimit dy fotografi dhe mandati i arkëtimit i tarifës së shkollimit.

- **Studentët e regjistruar në master 2012-2013**

Ne ciklin e dytë viti I u regjistruan 168 dhe kanë derdhur tarifën e regjistrimit 164 studentë. Tre studentë nuk kanë paguar tarifën e regjistrimit dhe 1 student ka derdhur gabimisht tarifën e regjistrimit nga 2500 në vlerën 1600.

Në përfundim të auditimit u dhanë disa rekomandime:

- Të kryhet sistemimi I tarifës së regjistrimit për studentit e Fakultetit të Arteve të Bukura, të kryhet pagesa e regjistrimit nga tre studentët.
- Ngarkohen dega mësimore dhe sekretarite e fakulteteve të procedojnë me kryerjen e pagesës së tarifës së shkollimit për 442 studentë të mbetur, për të gjitha ciklet e studimit deri në datën 15 Maj 2013.

Auditimi tematik "Mbi rregullshmërinë e procesit dhe procedurave të inventarizimit lidhur me sallë Black Box në UART"⁷, u krye në datë 29.03.2013 mbi gjendjen fizike të bazës materiale nga i cili rezultoi:

- Inventari kontabël I marrë nga Drejtoria Ekonomike nuk ka ndryshime me gjendjen fizike të bazës material në sallën Black Box.
- Në sallën Black Box u konstatuan disa mallra të dëmtuara prej shumë vitesh, duke mos qënë të dobishme për aktivitetin e sallës.
- Në sallën Black Box u konstatuan disa pode që nuk janë inventarizuar në financë.

Për sa më sipër rekomandojë: Të krijohet një komision me specialistë për vlerësimin e tyre dhe më pas ato që konstatohen jashtë përdorimit në bazë të procesverbalit të shikohet mundësia për kalim inventari në një gjendje tjetër.

Të kryhen shërbime të rregullta mirëmbajtje për minimizimin e avarive të mundshme për të siguruar eficientësinë e aktiveve.

Në datën 02.09.2013 u përgatit një program auditimi "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë ligjore në pagesat e personelit akademik për vitin 2012-2013", për të cilin nuk ka ende një raport përfundimtar.

Në datë 27.11.2013 me urdhër të Rektorit të Universitetit të Arteve z. Petrit Malaj është ngritur një grup kontrolli "Për ushtrimin e kontrollit të brendshëm të ligjshmërisë në Fakultetet e universitetit të Arteve", në të cilin është pjesë edhe Auditi i Brendshëm.

⁷ Bazuar në Urdhrin Nr. 12, datë 28.03.2013

2. AUDITIMI I JASHTËM

Universiteti i Arteve është audituar gjithashtu nga Auditi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Auditimi u krye në zbatim të programit të auditimit nr. 905, datë 06.11.2013 (MAS), gjatë muajit nëntor 2013, me objekt "Auditim mbi bazë sistemi (Të përputhshmërisë, të performancës dhe financiarë). U auditua periudha 01 janar 2012 deri 30 shtator 2013. Gjatë realizimit të misionit u bë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ekspozimin e njësisë ndaj riskut. Qëllimi i misionit ishte dhënia e sigurisë objektive dhe menaxhimi i riskut në funksion të realizimit të objektivave duke siguruar dobi, frytshmëri dhe kursim të fondeve publike.

Në përfundim të misionit rezultoi ndër të tjera se:

- Sistemi i listë-pagesave është në përputhje me legjislacionin në fuqi, me procedurat dhe me politikën e menaxhimit.
- Janë bërë rakordimet periodike me sistemin e thesarit lidhur me pagesat dhe transferimet përkatëse.
- Blerjet janë bërë sipas kërkesave dhe nga personat e autorizuar, janë bërë hyrje dhe janë marrë në evidencën kontabile.
- Likuidimi i blerjeve është bërë sipas faturave të konfirmuara dhe nga llogarit buxhetore përkatëse.

Bashkëpunimi i stafit administrativ dhe akademik të UART me grupin auditues të MAS ka qenë mjaft i mirë dhe është siguruar i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e procesit të auditimit në përputhje me standardet.

PËRMBYLLJE

Duke qenë të ndërgjegjshëm se Universiteti i Arteve është një institucion i arsimit të lartë publik, me veçantitë e tij si në pikëpamje të ofertës formuese ashtu edhe në pikëpamje të administrimit administrimit akademik, administrativ e financiar, ne, gjithë anëtarësia e kësaj shkolle, jemi të angazhuar për të realizuar me gatishmëri të gjitha proceset e nevojshme, që e çojnë përpara Universitetin tonë.

Sfidat që qëndrojnë para nesh janë të shumta e të shumëllojshme, sidomos ato që lidhen me çështje të financimit të këtij institucioni. Për shkak të specifikave tona, mbështetja e autoriteteve shtetërore, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qeverisë apo strukturave të tjera është një element thelbësor në mbarëvajtjen e shkollës sonë. Përballimi i proceseve akademike me buxhet minimal, na ka detyruar që shpesh herë të cedojmë nga kërkesat për arritjen e niveleve maksimale, megjithatë përpjekjet tona duhet të drejtohen në gjetjen e rrugëve dhe mundësive alternative për sigurimin e fondeve.

Një plan veprimi strategjik në drejtim të eksplorimit të mundësive të financimit dhe gjetjes së burimeve të gjithanshme dhe të pranueshme, do të jetë një hap i cili do të konkretizohet brenda një kohe jo shumë të largët. Shpalosja e kapaciteteve akademike, krijuese e artistike të Universitetit të Arteve, pedagogëve e studentëve të këtij Universiteti do të shihet si një çelës i suksesit të shkollës sonë, me qëllim garantimin e jetëgjatësisë dhe rritjes së cilësisë së ofertës formuese që ne ofrojmë nga viti në vit.